

# VETERANI

GAZETË PERIODIKE

NR.1 (367)

JANAR 2019

ÇMIMI: 30 LEKË

Kryeredaktor: Halil RAMA ; Zv/Kryeredaktor: Sakip Cami

Email: veterani.obvl@yahoo.com / website: www.VETERANIOBVL.ORG

## JUBILARE



**Konferenca e Bujanit, 75 vjet nga rezoluta për vetëvendosje**

FAQE 5

## HISTORIA



**45 vjet më parë - Operacioni i madh armik i Dimrit '1943-1944**

*Faqe të lavdishme nga lufta heroike e Ushtrisë Nacionalçlirimtare*

Ing. Myfit GUXHOLLI

FAQE 4

## HOMAZH



**LAMTUMIRË DHIMITËR NDRENIKA**

*Për një nga kontribuesit në LANÇ dhe një nga pedagogët e shquar të "Akademisë Ushtarake Shqiptare"*

FAQE 6

## TAKOHEMI PËR NJË LIBËR.....

Halil RAMA

Duket disi e pabesueshme, por është fakt i pamohueshëm. Legjenda e qëndresës gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe në burgjet e diktaturës, gjenerali 100 vjeçar Rrahman Parllaku – Hero i Popullit dhe Nderi i Kombit, u aksidentua në mes të nëntorit 2018 në bibliotekën e shtëpisë së tij me më shumë se 1000 tituj. Po përzgjidhte bibliografinë për kolanën "NJË SHEKULL NË MEMORIE" (me tre libra me kujtime), dhe një marramendje e çastit e rrëzoi për dysheime, duke i shkaktuar frakturë në këmbën e djathtë. Legjendës në kufirin e tri kohëve – siç e ka cilësuar shkrimtari i mirënjohur Teodor Laço - libri ia mbajti të gjallë kujtesën dhe e ndihmoi të ruante freskinë e mendimit e veprimit edhe pasi kishte provuar torturat më mizore të hetuesisë Speciale.

Duket qartazi kjo te "ditari i mbajturi", gjatë 17 viteve në burgjet e diktaturës, ku për 96 librat që ka lexuar, në pak rreshta ka shënuar: autorin, temën, idenë dhe veprimet e personazheve". Edhe tani në kapërcyellin e një shekulli jete ai i është përkushtuar totalisht librit...Jo vetëm duke lexuar, por edhe duke shkruar kujtime për t'ua lënë si testament brezave.Po ato ditë të operimit dhe ripërtëritjes së "plagës së tretë" në spitalin e Traumës në Tiranë (pas dy plagëve lufte në malet e Kurveleshit e Junikut më 1943 e 1944), nipi i tij, Enver Parllaku, që nga Philadelphia, krahas interesimit për shëndetin e xhaxhait, do më porosiste: "Ribotojeni librin

FAQE 7

Deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë votuar për tri projektligjet që i hapin rrugë transformimit të FSK-së në ushtri

# Historike! Kosova bëhet me ushtri



**• 14 Dhjetor 2018 - Ditë historike për Kosovën. Tashmë shteti më i ri në Evropë është bërë me ushtrinë e tij. Pas vitesh nga shpallja e pavarësisë, Kosova diti të jetë e duruar dhe në fund të marrë vendime të mençura në shërbim të vendit dhe të forcimit të sigurisë**

FAQE 6

## FOKUS

**BBC: Ëndërrimtarët e Ushtrisë së Kosovës tërbojnë Serbinë**

*BBC ka shkruar për votimin për formimin e ushtrisë së Kosovës dhe rrugëtimin e shtetit të ri evropian deri në krijimin e ushtrisë*

FAQE 2

## OPINION

*Ushtria e Kosovës ose FSK-ja në të ardhmen do të ketë 5.000 ushtarë aktivë dhe 3.000 rezerve dhe një buxhet prej 98 milionë euro*

**KOSOVA ME USHTRI PËR PAQE, SOVRANITET DHE DINJITET**

Nga Bashkim Hisari

FAQE 7

## DEKLARATA

**OBVL: KRIJIMI I USHTRISË SË KOSOVËS, NGJARJE E PËRMASAVE KOMBËTARE DHE HISTORIKE**

FAQE 8

## FESTAT

**PËRMETARËT NDEROJNË SAKRIFICAT DHE GJAKUN E DËSHMORËVE**

MUHAREM KAMANI

FAQE 7

## PROFIL

**SHPENDI TOPOLLAJ – KRITIKU ME STIL TË QARTË DHE KULTURË TË MADHE**



DR. SHK. NOVRUZ ZEJNATI

FAQE 10

## SPORTI

**ALPINISTI NGA LURA LAZER RAJTA, NË KRYE TË SHOQATËS ALPINISTIKE "TIRANA"**

*Ish Sekretari Organizativ i Federatës së Alpinizmit shqiptar, dekoruar me Titullin "Mjeshtër i Madh"*

FAQE 9

## PERSONAZH

**Shuaip Methasani, veterani që rrezaton mirësi dhe vlera**

*Dy libra – testament për brezat ku përkruhen më së miri vendlindja, historia e lavdishme, personazhe e personalitete që kanë bërë historinë e traditat më të mira*

FAQE 8



## SPECIALE

Deputetët e Kuvendit të Kosovës më 14 dhjetor 2018 kanë votuar për tri projektligjet që i hapin rrugë transformimit të FSK-së në ushtri.

# Historike! Kosova bëhet me ushtri

14 Dhjetor 2018 - Ditë historike për Kosovën. Tashmë shteti më i ri në Evropë është bërë me ushtrinë e tij. Pas vitesh nga shpallja e pavarësisë, Kosova ditë të jetë e duruar dhe në fund të marrë vendime të menjçura në shërbim të vendit dhe të forcimit të sigurisë

## VESELI FTON KUVENDIN PËR NDERIM NDAJ GJITHË BREZAVE QË SAKRIFIKUAN PËR KOSOVËN

Në hapje të seancës parlamentare për formimin e Ushtrisë së Kosovës, kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli ka ftuar të gjithë pranishmit për një minutë nderim për të gjithë brezat, që në kohë e rrethana të ndryshme, sakrifikuan për këtë ditë.

“Le të nderojmë luftëtarët e kryengritjeve të mëdha të Kosovës të periudhave të ndryshme. Le të nderojmë gjeneratat e të burgosurve politikë. Studentët e lëvizjeve studentore. Intelektualët dhe minatorët e Kosovës. Bashkatdhetarët tanë kudo në botë. Veprimtarët politikë të rezistencës paqësore. Djemtë dhe vajzat e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Dëshmorët e lirisë. Ne sot qëndrojmë këtu falë kësaj sakrifice mbinjerëzore. Krenarë me të kaluarën dhe të sigurt për të ardhmen tonë euro-atlantike”, ka thënë kreu i Kuvendit Kadri Veseli në hapje të seancës kur u votua Ushtria e Kosovës.

## VOTOHEN TRI PROJEKTLIGJET QË I HAPIN RRUGË TRANSFORMIMIT TË FSK-SË NË USHTRI

Deputetët e Kuvendit të Kosovës më 14 dhjetor 2018 kanë votuar për tri projektligjet që i hapin rrugë transformimit të FSK-së në ushtri.

Kjo ditë është cilësuar si historike si nga liderët e vendit, po ashtu edhe nga aleatët ndërkombëtar. Njohësit e fushës pohojnë se transformimi i tërësishëm në ushtri është një proces që mund të zgjasë deri në 10 vite.

Deputetët kanë votuar për Projektligjin për Ministrinë e Mbrojtjes, Projektligjin për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Projektligjin për shërbim në Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Kuvendi i Kosovës miratoi tre ligjet që bëjnë të mundur transformimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës në ushtri. Bëhet fjalë për Ligjin për Ministrinë e Mbrojtjes, atë për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Ligjin për Shërbim në Forcën e Sigurisë së Kosovës. Të tri



këto ligje janë miratuar në parim gjatë muajit nëntor, më pastaj janë shqyrtuar nëpër komisione parlamentare dhe

tani presin edhe miratimin final nga Kuvendi. Ligji për Ministrinë e Mbrojtjes u miratua me 106 vota pro, asnjë

kundër. Në sallë kanë qenë të gjitha grupet parlamentare, përveç Listës serbe.

\*\*\*

Kuvendi i Kosovës ka miratuar të gjitha ligjet për formimin e Ushtrisë së Kosovës. Nga 14 dhjetori 2018, Kosova do të ketë ushtrinë e vet.

Ushtria jo e Kosovës do të jetë më e reja në botë dhe kjo falë përkrahjes së Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe shteteve tjera mike të Kosovës.

Transformimi i tërësishëm i FSK-së në ushtri është një proces që mund të zgjasë 7-10 vite. Disa ditë më parë nga Amerika në Kosovë, kanë arritur 24 automjete ushtarake “Humvee”. Këto automjete i kanë kushtuar buxhetit të Kosovës rreth 7 milionë euro. FSK do të marrë edhe 27 automjete të tjera “Humvee”, të cilat janë donacion nga Ushtria Amerikane.

## BBC: Ëndërrimtarët e Ushtrisë së Kosovës tërbojnë Serbinë

BBC ka shkruar për votimin për formimin e ushtrisë së Kosovës dhe rrugëtimin e shtetit të ri evropian deri në krijimin e ushtrisë. Në këtë artikull BBC shkruan se rrugëtimi euro-atlantik i Kosovës është vënë në dyshim gjatë javëve të fundit.

“Së pari vuri taksë 100 për qind ndaj produkteve të fqinjit, Serbisë. Tani deputetët do të votojnë për ngritjen e një ushtrie. Këto veprime nxitën paralajmërime, kërcënime dhe lutje nga Bashkimi Evropian dhe NATO-ja”, shkruan BBC.

Votimi i sotëm do të shndërronte 4 mijë pjesëtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës në ushtri profesioniste të Kosovës. BBC shkruan se Kosova është territor që mbrohet nga 4 mijë trupa të KFOR-it qëkur forcat serbe u larguan nga Kosova në vitin 1999, transmeton Koha.net. “Kryeministrja serbe Ana Bernabiq ishte aq e tërbuar nga votimi i ushtrisë sa foli për një kundërpërgjigje ushtarake. Presidenti serb kërkoi përkrahje nga Rusia dhe Kina”, shkruan BBC.

“Forcën ushtarake të Kosovës, Serbia e sheh si kërcënim ndaj 120 mijë pjesëtarëve të komunitetit serb në Kosovë.



Serbia nuk e njeh Kosovën që deklaroi pavarësinë e saj para dhjetë vjetësh”, ka shtuar mediumi britanik. BBC shkruan se një situatë krejt tjetër ishte para tre muajsh kur të gjitha bisedimet ishin për shkëmbim teritorësh mes Serbisë dhe Kosovës, për t'i dhënë fund mosmarrëveshjes së tyre të gjatë, pas gjashtë vjetësh negociata të nisura nga Brukseli.

“Ky plan është largim nga statusi i Kosovës i projektuar nga fuqitë perëndimore. Në Kosovë ka shumë misione të Bashkimit Evropian, gjithashtu është edhe KFOR-i. Ky shtet përfiton shumë nga ndihma ndërkombëtare”, shkruan BBC.

“Pra kishte elemente të kafshimit të dorës që po ushqente Kosovën në këto dy dekadat e fundit kur kryeministri Ramush Haradinaj akuzoi Federica Mogherinin se e ka mbytur procesin e dialogut”, shkruan BBC që citon Haradinajn: “Ajo ka transformuar dialogun nga ai për normalizim në dialog për teritorë. Kjo ka dëmtuar rajonin tonë”.

### Kundërshtimet e taksës

BBC shkruan se reagimi i Haradinajt ishte kundër shkëmbimit të territorit, plan të cilin e ka kundërshtuar shumë. Kjo erdhi si përgjigje ndaj BE-së që kundërshton vendimin e Kosovës për taksën ndaj Serbisë dhe Bosnjës. “[Ky] vendim është kundër shpirtit dhe bashkëpunimit në rajon”, citon Mogherinin BBC-ja. “Pres nga qeveria e Kosovës që të tërheqë vendimin.

Por besoj se dy palët mund të vazhdojnë dialogun”, ka thënë ajo.

### DISA JANË MË PAK OPTIMISTË PËR KËTË GJË.

“Tash jam më i shqetësuar për marrëdhëniet mes Serbisë dhe Kosovës sesa isha më parë”, ka thënë James Ker-Lindsay, njohës i Ballkanit në London School of Economics.

“Dialogu nuk ka qenë i mirë për disa vjet, por kishte ekuilibrim. Kjo ka ndryshuar dhe është e vështirë të parashikosh se ku do të shpie”, ka thënë ai.

BBC-ja shkruan se vendosshmëria e Kosovës për të shndërruar FSK-në në ushtri i ka përkeqësuar gjërat. Sekretari gjeneral i NATO-s, Jens Stoltenberg planin për ushtri e ka quajtur si vendim që vjen në kohë të papërshtatshme dhe ka paralajmëruar “pasoja serioze për të ardhmen e Kosovës për integrimin euro-atlantik”.

Shtytje e madhe për Prishtinën është Amerika që me qëndrimin e saj të kundërt me atë të Brukselit dhe NATO-s, ka përkrahur formimin e një ushtrie, transmeton Koha.net. BBC-ja shkruan se formimi i ushtrisë në këtë kohë vjen si frustrim i Prishtinës për mosliberalizimin e vizave nga BE-ja për qytetarët e Kosovës.

“Dhjetë vjet që prej pavarësisë Kosovës i mungojnë shumë gjëra të shtetësisë. Shndërrimi i FSK-së në ushtri, së paku do të ishte një arritje e planifikuar”, shkruan veç të tjerash BBC.





**SPECIALE**

# SHBA, “DRITË JESHILE” FORMIMIT TË USHTRISË SË KOSOVËS

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, i sapokthyer nga vizita e tij në Shtetet e Bashkuara, ka bërë të ditur se ka marrë “bekimin” e Amerikës për transformimin e FSK-së në Forcë të Armatosura të Kosovës.

Deklarata e tij është mbështetur edhe nga Ambasada amerikane në Prishtinë, që ka njoftuar se e mbështesin krijimin e ushtrisë së Republikës së Kosovës, por duke folur për një ushtri me mandat të kufizuar vetëm për vetëmbrojtje territoriale.

“Shtetet e Bashkuara të Amerikës vazhdojnë të mbështesin tranzicionin e disiplinuar dhe transparent të FSK-së në ushtri profesionale, shumetnike dhe në bashkëpunim me NATO-n, me një mandat të kufizuar për vetëmbrojtje territoriale. Asnjë vend nuk mund ta përdorë veton për këtë tranzicion”, thuhet në përgjigjen e Ambasadës amerikane në Kosovë.



Sipas selisë diplomatike amerikane, ky proces duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe të ketë parasysh natyrën shumë-

nike, pa harruar që çdo gjë duhet të koordinohet me aleatët dhe NATO-n.

“Ne u bëjmë thirrje udhëheqësve

politikë të Kosovës, që të sigurohen se ky proces do të vazhdojë në mënyrë gjithëpërfshirëse, të pasqyrojë natyrën shumetnike të Kosovës. Është thelbësore që Kosova, nga ky moment e tutje, të jetë e koordinuar ngushtë me aleatët e NATO-s dhe se duhet të angazhohen deri në tranzicion me të gjithë qytetarët”, thuhet në përgjigjen e Ambasadës së SHBA.

Gjatë vizitës në Amerikë, kryeministri Ramush Haradinaj u takua edhe me Sekretarin e Mbrojtjes, James Mattis, duke marrë mbështetjen e tij për të vazhduar përpara me formimin e ushtrisë. “Kosova ka bekimin e Shteteve të Bashkuara, Ministrisë së Mbrojtjes, për ushtrinë e Kosovës. Është mbështetja më e mirë që sjellim nga Amerika këtë kohë”, ka deklaruar Haradinaj.

**Top Channe**

## Meta: Vendim historik për ushtrinë, Kosova e aftë për përgjegjësi

Presidenti i Republikës Ilir Meta ka qenë i pari nga politika dhe institucionet shqiptare që ka përshëndetur krijimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Kosovës.

Në një postim në “Facebook”, Meta shkruan se ky vendim historik dëshmon se Kosova është e aftë për përgjegjësi të reja.

“Vendimi historik i krijimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Kosovës dëshmon qartë që Kosova është e aftë të marrë përgjegjësi të reja në ndërtimin e institucioneve demokratike dhe për të kontribuar vendosmërisht për paqen, stabilitetin e rajonit dhe fqinjësinë e mirë. Fry-



ma euro-atlantike qëndron në themel të këtij ndryshimi historik”, shkruan Presidenti i Republikës.

## Sovraniteti territorial i Kosovës është në duar të sigurta

**Këshilli i ambasadorëve Shqiptarë, ka përshëndetur votimin e Kuvendit të Kosovës, i cili i hapi rrugë krijimit të Forcave të Armatosura.**

**Përmes një deklarate për mediat, Këshilli i Ambasadorëve shkruan se krijimi i Forcave të Armatosura të Kosovës, është një lajm i mirë për të gjithë pasi tashmë sovraniteti territorial është në duar të sigurta.**

Ja deklarata e Këshillit të Ambasadorëve:

Këshilli i Ambasadorëve Shqiptarë vlerëson se votimi i datës 14 Dhjetor në Kuvendin e Kosovës në mbështetje të krijimit të Forcës së Armatosur të Republikës së Kosovës është një zhvillim që vjen në kohën e duhur.

Kosova duhet të jete e aftë të

mbrojtë sovranitetin dhe integritetin territorial të saj nga çdo kërcënim i jashtëm dhe nuk do të përbëjë rrezik për asnjë nga vendet fqinje.

Transformimi i FSK-së në një Forcë të Armatosur do të forcojë perspektivën Euro-Atlantike të Kosovës dhe do ti shërbejë paqes e stabilitetit rajonal.

Këshilli i Ambasadorëve Shqiptarë përshëndet qëllimin dhe dëshirën e Kosovës për tu kthyer nga një konsumuese në një kontribuese të sigurisë në rajon e më gjerë.

Në këtë kontekst, Këshilli i Ambasadorëve Shqiptarë përshëndet iniciativën e Qeverisë së Kosovës për hartimin e projektligjeve dhe krijimin e kuadrit të nevojshëm ligjor për transformimin gradual të Forcës së Sigurisë së Kosovës në një Forcë të Armatosur të Republikës së Kosovës.

## SHBA PËRKRAH FORMIMIN E USHTRISË SË KOSOVËS

### Teuta Sahatqija

Teuta Sahatqija, Konsulle e Republikës së Kosovës në New York, ka thënë se Shtetet e Bashkuara të Amerikës përkrahin formimin e Ushtria e Kosovës.

Të jesh Mision i Republikës së Kosovës në New York, si shtet jo anëtar i Kombeve të Bashkuara, e bënë misionin mjaftë të vështirë, por kjo aspak nuk na ndalë për të kryer punën në shërbim të atdheut, thotë, Teuta Sahatqija, Konsulle e Republikës së Kosovës në New York.

Ajo theksoi se Serbia, si anëtare e Kombeve të Bashkuara është shumë agresive dhe nuk zgjedhë mjete të minojë sovranitetin e Kosovës në mesin e anëtarëve të Kombeve të Bashkuara.

Por, sipas saj, Kosova ka miq të fuqishëm si ambasadorja Nikki Haley nga Misioni i SHBA-së, që fuqishëm llobon për njohjen e Kosovës nga shtete e ndryshme, dhe për anëtarësim në organizata.

Duke folur për mbështetjen e SHBA-ve, për formimin e Ushtrisë së Repub-



likës së Kosovës, Sahatqija, theksoi se gjatë punimeve të Asamblesë së Përgjithshme të KB-së, në shtator, kryeministri Haradinaj mori përkrahjen e fuqishme nga Departamenti i Shtetit Amerikan, për formimin e Ushtrisë së Kosovës.

“Ne kemi edhe një Konsullatë në Iowa, e cila në veçanti merret me bashkëpunimin e armatës amerikane dhe asaj të Republikës së Kosovës. Kjo, tregon përkrahjen dhe angazhimin e veçantë që SHBA, ia kushton fuqizimit të FSK-së dhe shndërrimit në saj në Ushtri”, thonë mes tjerash në intervistë.

## DEKLARATA

### OBVL: KRIJIMI I USHTRISË SË KOSOVËS, NGJARJE E PËRMASAVE KOMBËTARE DHE HISTORIKE

Organizata e Bashkuar e Veteranëve të LANÇ (OBVL) ka uruar Kosovën për krijimin e ushtrisë së saj. Në deklaratën e saj të datës 15 dhjetor 2018 OBVL shprehet se “Pas Pavarësisë, ngjarja e dytë e përmasave kombëtare dhe historike. Me Ushtrinë e saj Kosova do të jetë më e sigurtë, rajoni më në paqe, kombi shqiptar i integruar dhe më i forte. Nderim të rënëve për liri, mirënjohje miqve të mëdhenj që na mbështetën!”.



## HISTORIA

Faqe të lavdishme nga lufta heroike e Ushtrisë Nacionalçlirimtare

# 45 vjet më parë - Operacioni i madh armik i Dimrit '1943-1944



Ing. Myfit GUXHOLLI\*

Në fundin e vitit 1943, Ushtria Nacionalçlirimtare ishte rritur e forcuar dhe godiste pa pushim armikun. Në këtë kohë, e favorizuar dhe nga kushtet e jashtme si fitoret e Ushtrisë Sovjetike dhe të Aleatëve, Ushtria Nacionalçlirimtare kishte çliruar edhe mjaftë qytete si Dibra, Peshkopia, Kruja, Berati, Gjirokastra dhe harta e teritoreve të çliruara po shtrihej deri në Vlorë. Po rrezikoheshin rrugët e Lëvizjes së Ushtrisë Naziste. Kjo gjendje e shqetësonte shumë komandën gjermane. Në këto kushte, kryekomandanti i forcave naziste gjermane deklaronte: "Deri tani ne i kemi besuar mikpritjes dhe besës shqiptare, por nuk mundemi të durojmë më gjatë sulmet; duhet të marrim masa për sigurinë tonë". Në të njëjtën kohë, qeveria tradhtarë e Tiranës, u vu drejtpërdrejt në shërbim të okupatorit dhe mobilizoi forcat e veta për të asgjësuar forcat partizane. Gjermanët iu vunë punës për përgatitjen e një operacioni ushtarak të përgjithshëm në Shqipëri. Qëllimi i këtij operacioni synonte asgjësimin e UNÇL dhe shkatërrimin e këshillave Nacionalçlirimtare, për të vendosur pushtetin e bashkëpunëtorëve të tyre.

Forcat naziste gjermane që vepronin në Shqipëri u përforcuan me forca të tjera të ardhura nga Greqia e Jugosllavia dhe që hynin në përbërjen e katër divizioneve gjermane (297, 181, 21, 104.) Efektivit i këtyre forcave armike arrinte rreth 30.000 veta, përveç afro 12.000 forca të Ballit Kombëtar e Legalitetit. Komandanti i Përgjithshëm i Operacionit ishte gjenerali nazist Fehm.

Ndërsa forcat e UNÇL arrinin rreth 20.000 luftëtarë; shumica e tyre të inkuadruar në batalione, grupe e brigade të rregullta (4 brigada, 9 grupe dhe 17 batalione). Armatimi i tyre ishte i thjeshtë: pushkë automatike, mitralozë të lehtë e të rëndë. Burimi kryesor i furnizimit të forcave partizane me veshmbathje, ushqim dhe municion ishte populli ndërkohë që llogaritej edhe furnizimi nga aleatët dhe kapja në luftë e depove dhe materialeve të ndryshme të armikut. Ajo kishte moral shumë të lartë dhe disiplinë të shëndoshë e të ndërgjegjshme sepse partizanët luftonin për një gjë të shenjtë, çlirimin e atdheut.

Komanda gjermane, pasi kishte përpunuar planin e operacionit dhe kishte bërë përgatitjet e nevojshme filloi nga zbatimi i tij qysh në Nëntor 1943 duke sulmuar UNÇL në zonën e Pezës dhe pastaj me radhë në zonat e Dibrës, Mallakastrës, Çermenikës, Shëngjergj-Martanesht, Korçës, Beratit, Gjirokastrës dhe Kurvelesh-Salari-Mesaplikut.

Pas disa goditjeve të vogla, komanda gjermane nazifashiste, kolaboracionistët e armatosur deri në dhëmbë goditjen kryesore e dhanë kundër forcave të Brigadës së 3-të dhe Grupit të Pezës. Forcat armike sulmuan nga drejtimet: Tirana, Ndroqi, Shijaku, Kavaja, Rogozhina e Pegini me qëllim rrethimin dhe asgjësimin e forcave partizane. Këto të fundit, megjithëse të armatosura me armë të lehta, pa ushqime dhe veshmbathje, në kondita dimri luftuan me trimëri të rrallë.

• **Përballimi me sukses i Operacionit të egër Armik të Dimrit '1943-1944 ka qenë prova më e rëndë për UNÇL shqiptare dhe për popullin shqiptar. Në luftime të ashpra në kushte të pabarabarta, në një dimër jashtëzakonisht të vështirë humbjet e partizanëve ishin mbi 1000 veta por radhët e UNÇL shqiptare u shtuan dhe u forcuan, ndërkohë u rrit besimi i popullit në fitoren mbi pushtuesin**



Shtabi i Përgjithshëm, duke vlerësuar rezistencën e armikut vendosi që Brigada e 3-të të kalonte në zonën e Çermenikës duke manovruar për të çarë rrethimin. Në të njëjtën kohë, Grupi i Pezës u urdhërua të luftonte me grupe të vogla kundër forcave armike të dislokuara në zonën e Pezës. Ushtria nazifashiste mundi të përshkonte zonën e Pezës gjatë operacionit. Këtu ajo dogji, vrau e shkatërroi, por partizanët e Pezës nuk mundi t'i asgjësonte.

## PARTIZANËT I ZBATUAN ME PËRPIK-MËRI DETYRAT

Pas operacionit të Pezës, okupatorët nazistë kryen sulme kundër forcave partizane të Dibrës e Peshkopisë. Edhe këtu partizanët luftuan me trimëri, por në pamundësi manovrimi në ato zona, detashmentet partizane në kondita të disfavorshme karshi armikut marrin urdhër për tu tërhequr dhe të kalonin në drejtim të Shqipërisë së Mesme e të Jugut. Njëkohësisht edhe zona e Tropojës nuk shpëtoi nga operacioni duke u sulmuar nga forcat gjermane dhe ato të Xhaferr Devës të cilat pasi e shkelën, e dogjën, plaçkitën popullin, arrestuan dhe rrahën në gjithë zonën e Malësisë.

Operacioni në krahinën e Mallakastrës u krye me forca të mëdha. U pushtua Berati dhe u vazhduar për në drejtim të Mallakastrës ku ishte përqëndruar një pjesë më e madhe luftarake e UNÇL për atë kohë, Brigada e I-rë. Forcat gjermane në bashkëpunim me ato kolaboracioniste sulmuan në drejtim të Fierit e Beratit. Në Gllavë sulmuan forcat kolaboracioniste sëbashku me ato naziste gjermane. Pra, forcat partizane ishin të rrethuara nga të gjitha anët. Mjaftonte një gabim i vogël dhe forcat partizane të asgjësoheshin. Komanda e Brigadës së I-rë, nën drejtimin e shokut Mehmet Shehu e vlerësoi drejt situatën dhe mori vendimin për të dalë nga rrethimi që po i përgatiste armiku. Partizanët zbatuan me përpikmëri detyrat dhe duke përdorur Lundrën e Vogël të Memaliajt kaluan lumin Vjosë për në krahinën e Mesaplikut. Në operacionin e krahinës së Mesaplikut e të Kurveleshit të Poshtëm, forcat e Brigadës së I-rë dhe ato të Zonës së I-rë Operative Vlorë-Gjirokastrë zhvilluan luftime të përgjakshme, duke i shkatërruar humbje të mëdha armikut në Vajzë, Gjorm e Qafa e Shëngjergjit. Forcat partizane, duke mos dashur të angazhoheshin në luftime të gjata frontale përpara një armiku superior

në forca e mjete, me një manovrim të shpejtë u tërhoqën nga pozicionet e para dhe zunë vijën Bolenë-Vranisht duke zhvilluar luftime të rrepta. Njëkohësisht ato kaluan në zonën e Kurveleshit të Sipërm. Më vonë, forcat kryesore të Brigadës manovruan në zonën e Zagorisë e Lunxhërisë. Një pjesë e tyre u bashkuan me forcat partizane të Qarkut të Vlorës duke kaluar prapa krahëve të armikut për tu kthyer përsëri në Mesaplik e Kurvelesh duke pastruar këto zona nga kolaboracionistët dhe armiku nazist.

## ÇARJA E RRETHIMIT NË MALET E MARTANESHIT E ÇERMIKËS

Në 15 ditëshin e dytë të Dhjetorit 1943, forca të shumta naziste gjermane dhe kolaboracioniste filluan operacionin kundër forcave partizane që vepronin në zonën Çermenikë-Shëngjergj-Martanesht. Para se të fillonin operacionin bënë disa goditje kundër partizanëve dhe përforcuan pozitat e tyre gjatë rrugës automobilistike Qafë e Thanës-Elbasan-Tiranë. Qëllimi i armikut ishte që forcat partizane të Brigadës 2-të e 3-të, si dhe batalionet e Çermenikës e Martaneshit të mbeteshin të izoluar dhe të asgjësoheshin. Me këto forca partizane ndodhej edhe Shtabi i Përgjithshëm. Ishte rasti që Shtabi i Përgjithshëm të tregonte më së miri organizimin e këtyre luftimeve kundër forcave të shumta armike të armatosura më së miri. Ai duhej të grumbullonte forcat e dy brigadave, asaj të 2-të e të 3-të si dhe të batalioneve të Martaneshit e Çermenikës në një komandë të vetme dhe të luftonin duke sulmuar e mbrojtur që të mund të çanin rrethimin. Por Shtabi i Përgjithshëm, sidomos Enver Hoxha vetë i katërt vendosi të largohesh në Jug të vendit, në zonën e Polisit. Ndërsa forcat partizane u lanë në dorë të shtabeve të tyre duke rrezikuar edhe shpërbërjen. Këto forca partizane luftuan me trimëri dhe vetmohim për të çarë rrethimin dhe me manovër të shpejtë arritën të shpërkateshin nga forcat gjermane dhe ato kolaboracioniste. Humbjet e këtyre forcave, sidomos të Brigadës së 2-të ishin shumë të mëdha. Forcat e Brigadës së 3-të kaluan në zonën e Matit e Lurës dhe më vonë në atë të Pezës ndërsa forcat e Brigadës së 2-të kaluan në zonën e Tiranës e Krujës. Veprimet luftarake të forcave partizane në operacionin e Shëngjergj-Martanesht-Çermenikës, si rrjedhojë i një vlerësimi jo të drejtë të situatës nga Shtabi i Përgjithshëm me

Enver Hoxhën në krye u shoqëruan nga një humbje e madhe e forcave partizane dhe nga një imazh i keq.

Pas këtyre goditjeve të vogla në të gjitha qarqet e vendit, më 7 janar 1944 filloi Operacioni Armik i Dimrit, njëherësh në zonën e Korçës, Elbasanit e Beratit. Armiku synonte ti shtynte forcat partizane sa më në Jug, ti rrethonte dhe ti asgjësonte ato.

Brigada e 4-të luftoi me trimëri e heroizëm në vijën e frontit....- Voskopojë-Gjergjevicë dhe nuk i lejoi forcat gjermane të përparonin. Ndërsa në zonën e Beratit, në drejtim të Tomoricës dhe nga Elbasani armiku mundi të përparojë dhe arriti në Mazrekë të Oparit. Kjo dalje vuri në rrezik forcat e Brigadës së 4-të e cila me një manovër të shpejtë çau rrethimin duke kaluar në Qafën e Beçit (Mali Ostrovicë) dhe kaloi në Potom (Skrapar). Gjermanët pushtuan Tomoricën, Sulovën, Nahijën e Beratit, Gorën dhe Oparin duke kryer një terror të paparë nëpër fshatra me synimin për të shpëputur nga lufta masat e popullit. Tentativa e armikut ishte që të dilte nga Çorovoda në Tendën e Qypit për në Përmet.

Forcat partizane të Qarkut të Beratit dhe sidomos forcat e Brigadës së I-rë luftuan heroikisht në Tendën e Qypit duke arritur që ti ndalojnë dhe ti detyrojnë të tërhiqen gjermanët. Një ndihmë të madhe dhanë dhe forcat partizane të Brigadës së 6-të që sapo ishte formuar në Përmet.

Gjermanët kudo që shkuan dogjën, vranë dhe plaçkitën por nuk ia arritën qëllimit për të shpartalluar Ushtrinë Nacionalçlirimtare. Armiku po të njejtin operacion bëri edhe në Qarkun e Vlorës kundër Brigadës së 5-të e cila u rrezikua seriozisht, por manovrimi i saj dhe ndihma e popullsisë bëri që ajo, jo vetëm të çante rrethimin, por ta godiste armikun në befasi.

## MËSYMJA E PËRGJITHSHME E UNÇL

Kur nazistët gjermanë dhe kolaboracionistët po i jepnin fund operacionit në pamundësi të asgjësonin Ushtrinë Nacionalçlirimtare shqiptare, forcat e UNÇL u hodhën në mësymje: Brigada e 5-të në Qarkun e Vlorës, Brigada e 4-të në Qarkun e Korçës, Brigada e I-rë në Qarkun e Beratit, Brigada e 6-të në zonën e Lunxhërisë e Zagorisë. Kështu ata i dhanë goditje të fortë armikut dhe filluan të çlironin të gjitha zonat që kishte pushtuar ai gjatë operacionit.

Përballimi me sukses i Operacionit të egër Armik të Dimrit '1943-1944 ka qenë prova më e rëndë për UNÇL shqiptare dhe për popullin shqiptar. Në luftime të ashpra në kushte të pabarabarta, në një dimër jashtëzakonisht të vështirë humbjet e partizanëve ishin mbi 1000 veta por radhët e UNÇL shqiptare u shtuan dhe u forcuan, ndërkohë u rrit besimi i popullit në fitoren mbi pushtuesin.

Gjatë Operacionit Armik të Dimrit u çimentua dashuria dhe besimi i patundur i luftëtarëve të lirisë për detyrën e lartë të çlirimit të Atdheut..., u rrit ndërgjegjja dhe përkushtimi i partizanëve për një organizim të përsosur, manovër të shkëlqyer e disiplinë të lartë të UNÇL. U rrit në shkallën më të lartë besimi i popullit tek Ushtria Nacionalçlirimtare si e vetmja forcë që do ta çlironte vendin nga pushtuesit gjermanë.

Ing. MYFIT GUXHOLLI  
Veteran i LANÇ – Nënkrjetar i OBVL



## JUBILARE

# Konferenca e Bujanit, 75 vjet nga rezoluta për vetëvendosje

Shtatëdhjetëpesëvjet më pare, nga 31 dhjetori 1943 deri më 2 janar 1944, është mbajtur Konferenca e Bujanit si rikonfirmim i rrethanave të reja të krijuara pas Mbledhjes së Mukjes, dhe si rezultat i mospërfshirjes së Kosovës dhe viseve tjera shqiptare nën sundimin e ish Mbretërisë SKS. Konferenca e Bujanit u mbajt pikërisht për t'i kundërshtuar vendimet e Mbledhjes së II të AVNOJ -it në Jajcë (29-30 nëntor 1943) dhe mos përfshirjes së Kosovës si subjekt i pavarur që deri atëherë ishte përfaqësuar përmes Malit të Zi në KAKJ-së.

## VENDNDODHJA DHE PJESËMAR- RËSIT E KONFERENCËS

Bujani si një vend pritje e përfaqësuesve të dy kombësive (shqiptarëve dhe serbëve) që kërkonin një marrëveshje për parandalimin e konflikteve të mëtejshme ndëretnike. Mbledhja e Konferencës u mbajt në kullën e Sali Manit, Bajraktarit të Krasniqes, që ndodhej pranë bazës së Shtabit Kryesor të UNÇ të Kosovës dhe të Komitetit Krahinor për Kosovë e Rrafshi i Dukagjinit, ku morën pjesë 49 delegatë që përfaqësonin të gjitha viset dhe shtresat shoqërore të Kosovës. Midis pjesëmarrësve kishte komunistë, nacionalistë dhe atdhetarët të tjerë demokratë, përfaqësues të Forcave të Armatosura, të rinisë e të gruas antifashiste etj [2].

Në këtë konferencë morën pjesë 49 delegatë që përfaqësonin popullin e Kosovës dhe forcat politike të rreshtuara te Fronti Antifashist Nacional-çlirimtar i Kosovës. Konferenca shqyrtoi tri ditë radhazi problemet që dilnin nga lufta kundër pushtuesit. Ajo zgjodhi kryesinë prej 9 vetash : Mehmet Hoxha (kryetar) ish-prefekt i Elbasanit, Rifat Berisha (nënkryetar), Pavle Joviqeviçin (nënkryetar), Xheladin Hana (anëtar), Fadil Hoxha (anëtar), Hajdar Dushi (anëtar), Zekeria Rexha (anëtar), Milan Zeçarin (anëtar) dhe Ali Shukriun (anëtar).

## REZOLUTA NGA KONFERENCA E BUJANIT

Konferenca e Bujanit doli nga kjo Konferencë me një dokument përfundimtar me rezolutë të miratuar në konferencë, ku thuhet : Kosova dhe Rrafshi

**• Konferenca e Bujanit ka filluar më 31 dhjetor 1943 dhe ka përfunduar më 2 janar 1944, në të cilën është nënshkruar një rezolutë, ku Kosovës i njihet e drejta e vetëvendosjes deri në shkëputje dhe realizimi i dëshirës së popullit shqiptar të Kosovës për bashkim me Shqipërinë.**

i Dukagjinit është krahinë e banuar me shumicë nga populli shqiptar, i cili, si gjithmonë, ashtu edhe sot, dëshiron me u bashkue me Shqipërinë. Formulimi i një qëndrimi të tillë, siç thoshte Hajdar Dushi, mbështetjet në vetë deklaratat e PKJ-së dhe të KANÇ-it të Jugosllavisë, në të cilat njihej parimi i vetëvendosjes së popujve deri në shkëputje, parim bazë ky i Kartës së Atlantikut, i shpalur solemnisht nga aleatët e koalicionit antifashist. Më poshtë në rezolutë theksohej se Lufta e përbashkët me popujt e tjerë të Jugosllavisë kundër okupatorit nazist gjaksuer e rrogatëve të tij, është e vetmja rrugë për me fitue lirinë, në të cilën të gjithë popujt, pra edhe populli shqiptar, do të kenë mundësi me vetëvendosë mbi fatin e tyre, me të drejtën e vetëvendosjes deri në shkëputje. Garant për këtë është UNÇ i Jugosllavisë dhe UNÇSH i Shqipërisë, me të cilën është ngushtësisht e lidhur. Përveç këtyre, për këtë garantojnë aleatët tanë të mëdhenj, Bashkimi Sovjetik, Anglia e Amerika (Karta e Atlantikut, Konferenca e Moskës dhe e Teheranit). Kosova dhe Rrafshi i Dukagjinit është një anë, e



Kulla e Bajraktarit të Krasniqes ku mbajt Konferenca e Bujanit

cila popullohet në pjesën më të madhe nga popullsia shqiptare, e cila, si gjithmonë, dëshiron edhe sot të bashkohet me Shqipërinë. Prandaj, e ndiejmë për detyrë t'a vëmë në dukje rrugën e vërtet në të cilën duhet të ecë populli shqiptarë për të realizuar aspiratat e vehta. Rruga e vetme për tu bashkuar me Shqipërinë, për shqiptarët e Kosovës dhe të Rrafshi i Dukagjinit, është lufta e përbashkët me popujt e tjerë të Jugosllavisë.

## JEHONA E KONFERENCËS SË BUJANIT

Në vitin 1946 Tito ka deklaruar për agjencinë amerikane Associated Press se Kosova dhe territore të tjera shqiptare do t'i kthehen Shqipërisë. Udhëheqësi i ish-Jugosllavisë, Josip Broz Tito i ka premtuar Enver Hoxhës, në vitin 1946, se do t'i kthente Kosovën dhe territore të tjera shqiptare që ndodheshin në bashkimin jugosllav. Gazeta serbe Pravda shkruan se Tito në vitin 1946 për pak sa nuk i ka "dhuruar" Hoxhës Kosovën dhe Metohinë, por edhe territore të tjera shqiptare. Pak e njohur është për botën [5], ku ish-udhëheqësi jugosllav kishte thënë hapur se: Kosova dhe territore të tjera me shumicë shqiptare do t'i kthehen Shqipërisë, transmeton Shekulli shkrimin e gazetës serbe. "Nëse komunistët vijnë në pushtet në Shqipëri, ajo (Kosova) mund të jetë nën juridiksionin e Tiranës", ka thënë atëbotë udhëheqësi jugosllav për "Associated Press". "Kreu i shtetit shqiptar, Enver Hoxha gjithmonë ka thënë se marshall Tito i ka premtuar në fund të qershorit të vitit 1946, se Kosova dhe territore të tjera me shumicë shqiptare do të jenë pjesë e Shqipërisë. Megjithatë, këtyre deklaratave nuk u është dhënë rëndësi pasi marrëdhëniet mes Tiranës dhe Beogradit kanë qenë gjithnjë të tensionuara", shkruan më

tej gazeta serbe. Dora e djathtë e Titos, Edvard Kardel, sipas disa teorive konspirative, me rastin e vizitës së tij në Moskë i kishte thënë Stalinit se Kosova do t'i jepet Shqipërisë, me luftën e tyre kundër okupatorit dhe shërbëtorëve të tij

Sepse, kjo është rruga e vetme për të fituar lirinë, kur të gjithë popujt, pra edhe shqiptarët, do të kenë mundësinë që të deklarohen rreth fatit të vet, me të drejtën për vetëvendosje deri në shkëputje. Tryezë Shkencore, në 70 vjetorit të Konferencës historike të Bujanit.

Në këtë konferencë, siç dihet, u miratua rezoluta me të cilën Kosovës i njihet e drejta e vetëvendosjes deri në shkëputje dhe realizimi i dëshirës së popullit shqiptar të Kosovës për bashkim me Shqipërinë, u zgjodh Këshilli Antifashist Nacionalçlirimtar (parlamenti) dhe Kryesia (Qeveria e përkohshme) e Kosovës, 70 vjetori i shënimit të kësaj date historike të popullit shqiptar.

Konferenca e Bujanit është mbajtur më 31 dhjetor 1943 dhe 1 e 2 janar 1944, në të cilën është nënshkruar një rezolutë për bashkimin e shqiptarëve.

Në Konferencën e Bujanit ka qene sekretar "Tefik Çanga" i cili ishte dhe një nder iniciatorët dhe përkrahësit e levizjes Çlirimtare në Kosovë. U var në trekëndëshin te Çarshia e Gjakovës nga Gjermanet.

## ANGLEZËT

Në punimet Konferenca e Bujanit mori pjesë edhe përfaqësuesi i misionit anglez, major Baily, i cili ne mes te tjerave theksoi : Dëshiroj t'ju falënderoj për ftesën... Kam pasur kontakte me shume njerëz me botëkuptime te ndryshme politike. Lëvizja Antifashiste është e vetmja lëvizje qe lufton kundër armikut te përbashkët-fashizmit.





## HOMAZH

*Për një nga kontribuesit ne LANÇ dhe një nga pedagogët e shquar të “Akademisë Ushtarake Shqiptare”*

# LAMTUMIRË DHIMITËR NDRENIKA


Më 21dhjetor 2018, Familja, të afërmit, bashkëluftëtarët e bashkëpunëtorët, shokët dhe miqtë e shumë përcollën për në banesën e fundit, me të gjitha nderimet që meritonte veteranin e OBVL, Dhimitër Arqile Ndrenika.

Dhimitri ka lindur më 1928 në Vuno të Himarës, në një familje me tradita patriotike.

Ishte 14 vjeç kur u lidh me grupet e Rinisë në vitin 1942 dhe më 1944 u rreshtua partizan në Brigadën e Tretë Sulmuese. Mori pjesë në luftimet e kësaj brigade me trimëri e heroizëm deri në vitin 1945.

Mbas çlirimit të vendit nga okupatori nazifashist, duke vlerësuar aftësitë dhe punën e tij të mirë, u dërgua për studime jashtë shtetit, për artileri tokësore. E mbaroi shkollën me rezultate të shkëlqyera dhe më pas mori gradën “nëntoger”.

Pas përfundimit të studimeve ka



shërbyer në shumë reparte të ushtrisë.

Si oficer me përgatitje të lartë, Dhimitri ka punuar me përkushtim dhe ka lënë gjurmë të thellë në divizionet e Shkodrës, Burrelit e Tiranës, por edhe si pedagog i talentuar. Dhe së fundi në detyrën e komandantit të Artilerisë në Grupimin e Tiranës.

Dhimitri ka qenë kurajoz, gjithmonë ngrinte probleme për mbarëvajtjen e punës.

Me ndryshimet e ndodhura në vitin 1990 e më pas ai përkrahu proceset demokratike dhe që në fillim, me disa ish ushtarakë formoi Organizatën e Ushtarakëve në Pension dhe në Lirim. Dhimitri ka qenë iniciator, themelues, nënkryetar dhe për disa vite derisa ndërroi jetë, kryetar i OUP-së. Po ashtu dha kontribut në krijimin e Organizatës së Bashkuar të Veteranëve të LANÇ të popullit shqiptar, duke qenë një nga themeluesit dhe anëtar i kryesisë së kësaj organizate. Kontributi i tij

në OBVLka qenë shumë i vlefshëm.

Kontributi i tij është i njohur edhe si anëtar i Shoqatës së Atlantikut Verior, sot Këshilli Atlantik i Shqipërisë, ku në konferencat ndërkombëtare e veprimtari të tjera të tij jepte mendime të vlefshme si studjues dhe njohës i NATO-s.

Dhimitri ishte dhe një familjar i mirë dhe oficer model.

Për meritat e tij është vlerësuar dhe nderuar me Urdhëra e Medalje, si “Urdhëri i Skënderbeut”, etj.

Me vdekjen e tij, ne shokët e OBVL e OUP-së humbëm një kuadër të devotshëm të demokracisë. Familja humbi njeriun më të dashur të saj.

Lamtumirë shoku dhe mikut ynë i dashur Dhimitër Ndrenika!

*Të qoftë i lehtë dheu i tokës mëmë....*

**KRYESIA E OBVL**

**Nënkryetari**

**Myfit GUXHOLLI**

## DHIMITËR NDRENIKA NJË PERSONALITET I VEÇANTË I KOMBIT SHQIPTAR

U nda nga jeta në mëngjesin e të premtes së datës 21 dhjetor, një nga kontribuesit më të mëdhenj në Luftën Nacional Çlirimtare të Shqipërisë, një nga pedagogët e shquar të “Akademisë Ushtarake Shqiptare”, një nga ushtarakët me vlera të veçanta në fushën e artilerisë shqiptare, botues i librave shkencorë në këtë fushë, një bir, një vella, një baba, një bashkëshort, një mik i përkushtuar në jetë.

Dhimitër Ndrenika lindi në fshatin bregdetar të Himarës, Vuno, në 28 Mars 1928. Ai ishte djali i madh i familjes së Arqilea Ndrenikës, e përbërë nga katër fëmijë, dy djem dhe dy vajza. Familja e tij ishte një familje e njohur në Vuno, për patriotizmin dhe kontributin e saj. I ati i Dhimitrit, Arqilea Ndrenika ishte një patriot i shquar i Lëvizjes së Fan Nolit, dhe u kthye pas amnistisë që bëri mbreti Zog I, ai kishte kryer shkollën ushtarake dhe ishte oficer i xhandarmërisë së Mbretit Zog, i ati i

Dhimitrit i shërbyeu atdheut me devotshmëri dhe besnikëri, në çdo skaj të Shqipërisë nga Konispoli në Tropojë.

Dhimitër Ndrenika ka qenë student në Liceun e Korçës për 2 vjet në vitet 1940-1942, aty ai u frymëzua nga idetë e Rinisë Antifashiste Shqiptare. Në moshën 14-vjeçare ai doli partizan dhe ju bashkua Brigadës së III sulmuese, e krijuar më 9 Tetor të vitit 1943, në fshatin Arbanë të zonës luftarake të Pezës. Kjo Brigadë mori detyrë që në përbërje të Divizionit të I-rë Sulmues, me luftime të marshonte në drejtim të Verilindjes, Tiranë-Martanesh-Peshkopi-Kukës-Has dhe për në Malësinë e Gjakovës, nëpër një terren shumë të thyer e malor, duke kaluar Drinin e Zi e Drinin e Bardhë, në një dimër të ashpër. Dhimitër Ndrenika u kthye me këtë Brigadë nga Jugosllavia në atdhe në Dhjetor të vitit 1945, duke plotësuar detyrat për çlirimin e Atdheut.

Në vitin 1946 për devotshmërinë dhe aftësitë e tij të spikatuara, ai u dërgua me studime në Akademinë Ushtarake të Bashkimit Sovjetik për “Artileri Tokësore” për katër vjet. Ai mbaroi studimet me rezultate ekselente dhe u kthye në Shqipëri, ku punoi me përkushtim në Divizionin e Shkodrës, Burrelit dhe së fundmi në detyrën e Komandantit të Artilerisë në Grupimin e Tiranës, ku gjithmonë vihej re për kurajon, gadishmërinë e lartë dhe korrektësinë në punë, duke dhënë shembullin personal në radhë të parë.

Dhimitër Ndrenika ka qenë një pedagog i shkëlqyer në Akademinë Ushtarake, të Ministrisë së Mbrojtjes ku vihet re aktiviteti shkencor si:

- **Botimi i rregullores së qitjes së vitit 1968;**
- **Botimi i rregullores së mbrojtjes së vitit 1980;**
- **Ai ka përpiluar tekste për artilerinë të cilët janë në përdorim dhe sot si:**
- **Mbi zgjedhjen e pozicioneve të zjarrit tip tynel të vitit 1967;**
- **Drejtimi i zjarrit të grupimit të artilerisë i vitit 1969;**
- **Qitja e artilerisë tokësore për shkollat e larta e vitit 1972;**
- **Drejtimi i zjarrit të Artilerisë me topin e ndrequr e vitit 1969;**

Dhimitri mori pjesë në sesione shkencore të ndryshme ku mbajti dhe kumtesa, ai përpiloi tërë leksionet dhe metodikat e artilerisë së zjarrit të saj gjatë viteve 1975-1980.

Me ndryshimet e bëra në vitin 1990, ai përkrahu proceset demokratike dhe që ndër të parët që formuan Organizatën e Ushtarakëve në Pension



dhe Lirim për të luftuar për të drejtat e oficerëve në lirim të parakohshëm në pension.

Dhimitri ka qenë iniciator, themelues, nënkryetar dhe më vonë Kryetar i OUP-së. Nga kjo organizatë një pjesë e anëtarëve krijuan Organizatën e Bashkuar të Veteranëve të Luftës Antifashiste, ku ai ishte një nga themeluesit njëkohësisht dhe anëtar i kryesisë së OBVL-së. Përkushtimi dhe kontributi i tij në organizatë ishte i mjaft i çmuar.

Dhimitër Ndrenika ishte anëtar i Organizatës së Atlantikut Verior nga viti 1995 e në vazhdim, ai ka marrë pjesë në konferencat ndërkombëtare të kësaj organizate vazhdimisht si përfaqësues i OBVL-së.

Për meritat e tij ai është vlerësuar dhe nderuar me urdhëra e medalje të ndryshme si ai i Skënderbeut dhe në Nëntor 2015, me rastin e 70-vjetorit të Çlirimit të Atdheut u dekorua me “Medaljen e Mirënjohjes”, nga Ministria e Mbrojtjes.

Mirënjohje për kontributin tënd të rrallë Dhimitër Ndrenika, bir, vëlla, baba, bashkëshort, mik me vlera të veçanta!

**AKIL NDRENIKA**





## OPINION

# Takohemi për një libër...

**Halil RAMA**

“Një legjendë në kufirin e tri kohëve”, në 100-vjetorin e gjeneralit. Është kjo një porosi e veçantë e intelektualit të mirënjohur nga Novoseja e Kukësit, që ka bërë dhe bën aq shumë për librin. Jo vetëm në vendlindje ku sherbeu me devotshmëri e përkushtim për dhjetra vite në funksione të rëndësishme, por edhe atje në kontinentin e largët, si një ndër themeluesit e Shoqatës “Bijtë e Shqipërisë”, punën me librin e ka ndër prioritetet kryesore.

Në të njëjtën linjë, edhe artistja e Popullit Tinka Kurti, pasi ka marrë disa kërkesa nga diaspora shqiptare, shpreh interesimin për ribotimin e monografisë kushtuar gjeneral Parllakut. Ndërkohë ajo vlerëson të përditshmen “Telegraf”, nga ku ka lexuar disa artikuj biografikë për gjeneral Parllakun, si dhe për pasqyrimin me vërtetësi të ngjarjeve nga Lufta Nacionalçlirimtare.

## NJË LIBËR PËR ZHULALIN

Shkrimtari, diplomati dhe politologu Besnik Mustafaj, shprehet pa ngurrim për librin “Akhenda e një ministri (kushtuar Zhulalit) se nga pikëpamja e punës që bënte në gjysmën e parë të viteve '90, si diplomat, Safet Zhulali mbetet një ministër mbrojtjeje i jashtëzakonshëm. “Ai e kishte kuptuar shumë shpejt rëndësinë jetike që kishin marrëdhëniet ndërkombëtare në ngritjen e një sistemi sigurie kombëtare. Nuk e kam fjalën këtu vetëm për objektivin strategjik për integrimin në NATO. E kam fjalën për qasjen e drejtë dhe largpamëse që kishte aie dhe për ndërtimin e një bashkëpunimi dypalësh të rëndësishëm, të qëndrueshëm dhe afatgjatë me ushtritë e vendeve të botës demokratike, pra një bashkëpunim të mbështetur mbi vlerat e përbashkëta”, shprehet



z. Mustafaj. Ndër shumë raste që e shtojnë në këtë vlerësim, ai veçon vizitën zyrtare të Zhulalit në Paris në pranverë 1996, i ftuar nga homologu i tij francez. “Në përfundim të asaj vizite u arrit një marrëveshje bashkëpunimi midis dy ministrave të mbrojtjes, e tillë që nuk është tejkaluar ende sot pas 22 vjetësh. Në të gjitha bisedimet Zhulali ishte bindës, i besueshëm dhe i hapur, duke e treguar veten, përveç të tjerash, edhe një diplomat i një cilësie shumë të lartë”. Ndoshta dhe për evidentimin e këtyre cilësive të ministrit të parë të mbrojtjes të Shqipërisë postkomuniste, libri “Akhenda e një ministri” (ku ka dhe opinione të ish ambasadorit Ryerson, të ish sekretarit amerikan të Mbrojtjes William Perry, të ish Presidentit Mosiu si dhe të gjeneral Parllakut) është i një rëndësie të veçantë. Ndër të tjera në intervistën ekskluzive për këtë libër, ish-Sekretari Amerikan i Mbrojtjes William Perry shprehet: «E kam njohur z. Zhulali kur ai ishte Ministër i Mbrojtjes dhe mund të them se ka punuar me përkushtim



të madh për Shqipërinë dhe ka qënë një faktor i efektshëm për ta bërë Shqipërinë një anëtar të forte të Partneritetit për Paqe». Ndërsa për ish Ambasadorin William Ryerson: «Është diçka e mrekulluashme që Shqipëria është në NATO. E vetmja gjë që më vjen keq është që Safet Zhulali nuk arriti ta shikojë këtë sepse ajo ishte ëndrra e tij. Mendoj se është e rëndësishme për Shqipërinë së para së gjithash është një ekspozim më i madh ndaj Perëndimit dhe drejt BE-së».

## PANAIRET E LIBRIT DHE SIPËRMARRJA

Në Panairin e Librit “Tirana 2018”, shkrimtari i mirënjohur Zija Çela promovoi romanin e tij të ri me titull “Djalli komik”. Një roman ky për të cilin vetë Zija Çela thekson se në inversin e vet, do të quhej ndryshe “engjëlli i dashurisë”. Ndërsa analisti Agron Gjekmarkaj evidentoi si përcaktor në marrëdhënien e Çelës me letërsinë, dekadencën shoqërore të shndërruar në detaj. Ndërkohë, Lazër Stani thek-

soi se mbi të gjitha, Zija Çela është një shkrimtar i cili lexon lexuesit e tij.

Fondacionit “Alsar”, në harkun kohor të 6 mujorit të dytë 2018, ka promovuar dy botime dinjitoze të ambasadorit, publicistit dhe diplomatit Shaban Murati, profesor dhe Mjeshtër i Madh në Diplomaci: “Çështja e paqenë e detit, një intrigë diplomatike greke apo shqiptare “Kalvari diplomatik i shtetit të Kosovës”, që u prezantua për qindra diplomatë, analistë e gazetarë nga Shqipëria, Kosova, rajoni e bota. Një veprimtari e veçantë promovuese u organizua në një fshat të largët, ku në praninë e dhjetra intelektualëve dibranë u prezantua libri “Grazhdani i Dibrës”, shkruar me një stil të veçantë nga mësuesi në pension Neki Osmani. Një libër ku portretizohet Kalaja e Grazhdanit, si fortesë lufte dhe qëndrese, që përbën një shembëlltyrë historike; që evokon historinë e fshatit dhe traditën qytetëruese të tij, ndikimin dhe kontrollin mbi infrastrukturën provinciale përgjatë shekujve të V dhe VI. Por dhe një skedë e rëndësishme dhe e vlefshme për fshatin Grazhdan të Dibrës që sjell në kujtesë të kaluarën e largët të mugëtirës historike deri te e sotmja e jetuar. Jo më kot autori evidenton faktin se që në vitin 1974 Kalaja e Grazhdanit është shpallur monumet kulture dhe se “Turistët që vijnë në Dibër, duhet të shohin atë që i dha emrin Dibrës, këtë kala që është ndër më të mëdhatë në Ballkan”. Gjithsesi ky libër nuk do ta gjente dritën e botimit, pa kontributin modest dhe mbështetjen financiare të intelektualit dhe sipërmarrësit grazhdanas Edmond Isaku.

Të jesh një sipërmarrës është çështje talenti, por është edhe një dhuratë nga Zoti. Edmond Isaku i ka të dyja. Si themelues dhe administrator i TV “Bulqiza” në dy

dekada, ai ka dëshmuar se është një sipërmarrës i suksesshëm dhe i guximshëm, ka ide e aftësi menaxhuese, por është dhe një promovues e mbështetës financiar i botimit të disa librave dhe si i tillë ai zë vend të veçantë në Panteonin e Vlerave.

## INSTITUCIONET DHE PUNA ME LIBRIN

Përgëzime për punën me librin meritonjë edhe disa drejtues institucionesh kryesore. Kështu, Bujar Leskaj që drejtoj për shtatë vite Kontrollin e Lartë të Shtetit, i lë “trashëgimi” këtij institucioni, përveç selisë së re të standardeve ndërkombëtare edhe një bibliotekë mjaftë të pasur, ndërkohë që botimet e KLSH janë prezantuar denjësisht në disa panaire librash.

Punën me librin e ka vënë në prioritetet e tij edhe Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve, Stefan Çipa. Në më pak se katër muaj në drejtimin e burgjeve shqiptare, ai ka shpalosur vizionin perëndimor të reformimit të këtij sistemi, duke synuar një përafrim të shpejtë me standartet perëndimore. Dhe kjo edhe në drejtim të pasurimit dhe shfrytëzimit me efikasitet të plotë të bibliotekave në institucionet e vuajtjes së dënimit (përfshirë edhe inkurajimin, përkrahjen dhe botimin e krijimtarisë së disa personave të dënuar).

Po ashtu Dr. Ardit Bido, Drejtor i Përgjithshëm i Arkivit të Shtetit ka promovuar jo vetëm në Panairin e Librit 2018 në Tiranë, por edhe në rrethe, Kosovë e Maqedoni disa botime shken-core të këtij institucioni, shumë të vlefshme për publikun e sidomos për studjuesit.

Bashkia Dibër oraganizoi në qytetin e Peshkopisë fillim tetorin 2018, panairin me libra të 148 autorëve dibranë. Në mbyllje të këtij panairi, Administratori i Shtëpisë Botuese “M&B”, Bujar Karoshi u shpreh se ideja për realizimin e tij ka lindur në kuadrin e një jave kulturore në Dibër, e cila shpresojmë të kthehet në një traditë, sidomos kur të marrë udhë Rruga e Arbrit. Një javë plot veprimtari në vjeshtë ishte një prezantim shumë i mirë i Dibrës e cila ka shumë poetë, shkrimtarë e studiues të njohur, puna dhe sukseset e të cilëve janë një shembull i mirë për rininë atje. Gjithashtu, edhe nisma tjetër “Dhuro një libër” do të vazhdojë.

Iolla këto shembuj, për të “justifikuar” disi titullin (e librit tim ne proces) “Rizgjime meteorësh”, edhe për faktin se tërësia e lëndës së tij përbëhet kryesisht nga shënime për librat (botuar në të përditshmet “TELEGRAF”, në suplementin letrar “MILOSAO” të “Gazeta Shqiptare”, si dhe në të përjavshmen letraro-kulturore “NACIONAL”, parathënie (si redaktor i disa librave) dhe fjalë që kam mbajtur në promovimin e disa librave. Por edhe për të evidentuar dhe vlerësuar Lëvizjen Kombëtare për Lexim (LKL), nismë e Ministrisë së Kulturës të RSH e cila shpalli fundvitin 2018 programin “Shttt jam duke lexuar” (15 minuta leximi në 10 shkolla të Tiranës). Po ashtu, disa lëvizje dhe nisma për të nxitur leximin, si ajo “Takohemi për një libër” etj, dhe pasurimin e disa bibliotekave, janë punë që duhen lavdëruar dhe mbështetur.

## FESTAT

# Përmetarët nderojnë sakrificat dhe gjakun e dëshmorëve

**Muharem Kamani**

Në agimin e 28 Nëntorit sheshi “Abdyl Frashëri”, fasada e përmendores së partizanit dhe sheshi tek varrezat e dëshmorëve të atdheut në Përmet ishin zbukuruar si për festë, me flamuj, banderola, kurora dhe tufa me lule. Binin në sy flamujt kombëtarë në ballkonet e institucioneve, tek hyrja e qytetit, dhe flamuj të mëdhenj në lagjen “Varosh” tek shtëpia karakteristike përmetare “Gjergji Buxhuku” dhe tek vila në fasadën e shtëpisë së Pëllumb Muços. Në rrugët e qytetit ndihej atmosfera festive si dhe në sfond dëgjohej muzika atdhetare patriotike. U grumbulluan mjaft qytetarë në hyrje të bashkisë ku u zhvillua ceremonia festive e ngritjes simbolike të flamurit kombëtar. Ceremoninë e ngritjes së flamurit e hapi Kryetari i Bashkisë Z. Niko Shupuli i cili evokoi këtë ngjarje madhore historike të kombit shqiptar dhe foli për kontributin e përmetarëve për ditën e pavarësisë, si Mid’hat Frashëri, Veli Këlcyra, Sulejman Përmeti dhe të 12 çetave patriotike të rrethit të cilat sollën ditën e pavarësisë.

Mbas ngritjes së flamurit përpara bashkisë, të pranishmit u drejtuan tek varrezat e dëshmorëve ku u bënë homazhe tek dëshmorët e pavarësisë si: At’ Stath Melani, Kamber Bënja, Bilal Alipostivani, Mendu Zavalani, Izet Zavalani, Daut Muço Podgorani, Musa Fratari, Riza Vërçishti etj.

Më 29 nëntor në orën 10 mjaft veteranë, pjesëtar të familjeve të dëshmorëve, qytetarë, u grumbulluan pranë përmendores së partizanit. Mbas mbledhjes tek përmendorja, pjesëmarësit u drejtuan për të bërë homazhe tek varrezat e dëshmorëve. Me



kurora dhe tufa me lule në duar, ata qëndruan një minutë heshtje për të nderuar sakrificat dhe gjakun e dëshmorëve përpara obeliskut “Shokët”, vepër monumentale e “Skulptorit të Popullit” Odhise Paskali, “Nderi i Kombit”, nën tingujt e himnit kombëtar.

Është për tu marrë shembull që në këtë ditë të shënuar bënë homazhe të gjithë drejtuesit e të gjitha forcave politike, shoqatave atdhetare kulturore dhe drejtues institucionesh.

(Vijon ne faqen 11)



## OPINION

*Ushtria e Kosovës ose FSK-ja në të ardhmen do të ketë 5.000 ushtarë aktivë dhe 3.000 rezerve dhe një buxhet prej 98 milionë euro*

# KOSOVA ME USHTRI PËR PAQE, SOVRANITET DHE DINJITET

**Nga Bashkim Hisari**

Të gjitha shtetet, madje edhe ato neutrale, kanë forcat e tyre të armatosura. Numri më i madh i tyre kanë ushtri të fortë që vazhdimisht furnizohet me paisje luftarake dhe me armë të reja. Kosova deri më tash këtë mundësi nuk kishte edhe pse qysh para fushatës së bombardimeve të NATO-s mbi caqet serbe, Ushtria çlirimtare e Kosovës (UÇK) dhe qytetarët e Kosovës synonin dhe shpresonin për ta arritur qëllimin e lartë-formimit të ushtrisë që do të jetë në shërbim të gjithë qytetarëve, të shërbejë në gjithë territorin e Kosovës dhe të jetë garantuese e paqes dhe stabilitetit në rajon me synime për të qenë pjesë se NATO-së. Realizimi i këtyre aspiratave kushtëzohej nga rrjedhat ndërkombëtare gjeopolitike sidomos nga pushteti Serb i cili në vijim manipulon me serbët e Kosovës dhe me një politikë agresive në shumë bina, me mbështetjen e Rusisë, e të disa shteteve tjera, për të penguar shtetin e ri të Kosovës të mos realizoj dëshirat dhe të drejtat themelore.

Megjithatë me 14 dhjetor Kosova bëri histori duke e transformuar Forcën e Sigurisë së Kosovës (FSK-në) në Ushtri të vendit. Pavarësisht kundërshtimit të Serbisë, shqetësimeve të NATO-s dhe BE-së, por me përkrahjen e Shteteve të Bashkuara ta Amerikës, Britanisë së Madhe, Gjermanisë, Francës...Kuvendi i Republikës së Kosovës me votat e 107 deputetëve (deputetët e Listës Serbe, bojkotuan seancën e Kuvendit) në Kuvend prej 120 vendesh u miratua përfundimisht Ligji për Ministrinë e Mbrojtjes së Kosovës, Ligji për Forcat e Sigurisë së Kosovës si dhe Ligji për shërbim në Forcat e Sigurisë së Kosovës. Me këto ligje parashihet që FSK-a të zhvillohen si një forcë profesionale me kompetenca dhe detyra të reja, organizim dhe funksionim të ri dhe kalimin e Ministrisë së FSK-së në Ministri të Mbrojtjes.

Ushtria e Kosovës ose FSK-ja në të ardhmen do të ketë 5.000 ushtarë aktivë dhe 3.000 rezerve dhe një buxhet prej 98 milionë euro. Në kuadër të programeve dhe bashkëpunimeve të ndryshme shumë pjesëtarë të FSK-së u dërguan për trajnime jashtë vendit dhe u aftësuan për misionin e tyre. Ndihmë të madhe në këtë drejtim ofruan SHBA dhe Turqia. Aktualisht, FSK-ja ka 2.500 ushtarë aktivë dhe 800 rezervë. Ajo do jetë në shër-



bim të gjithë qytetarëve dhe do të shërbejë në gjithë territorin e Republikës së Kosovës, pra do të ketë mandate të funksionojë edhe në veri të vendit. Disa ditë më parë nga Amerika në Kosovë, kanë arritur 24 automjete ushtarake "Humvee". Këto automjete i kanë kështu buxhetit të Kosovës rreth 7 milionë euro. Forcat e Kosovës do të kenë edhe 27 automjete të tjera "Humvee", të cilat janë donacion nga Ushtria Amerikane.

Para miratimit të Ligjeve që Kosova të bëhet me ushtri, Presidentit i Sërbisë Aleksandër Vuçiç, bëri presion dhe përdori taktika të friksimit ndaj pjesëtarëve serb të FSK-së dhe tha se FSK do të rrezikoj stabilitetin dhe paqen rajonale, kurse kryeministrja Serbe Ana Brnabić paralajmëroi se ajo mund të urdhëroi një ndërhyrje të armatosur. Pala serbe me ndihmën e Rusisë kërkuan mbledhjen e jashtëzakonshme të Këshillit të Sigurimit (KS) të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB). Në mbledhjen e KS OKB-së më 17 dhjetor 2018 shumica e përfaqësuesve të shteteve anatare, theksuan se transformimi gradual i FSK-së në forcë të sigurisë nuk është në kundërshtim me Rezolutën 1244 të KS OKB-së dhe se është e drejtë sovranë e Kosovës të miratojë legjislacionin për formimin e ushtrisë. Ata bënë thirrje që transformimi të bëhet në mënyrë transparente, gjithëpërfshirëse dhe në koordinim të plotë me NATO-në e KFOR-in dhe midis Prishtinës e Beogradit të zhvillohet dialogu në interes të dy shteteve. Më parë 8 antare aktuale të KS të OKB-së, Britania e Madhe, Belgjika, Franca, Gjermania, Italia, Holanda, Polonia

dhe Suedia nënshkruan një deklaratë të përbashkët ku thuhet se është e drejtë e Kosovës që të krijojë ushtrinë e saj.

Transformimi i FSK-së në ushtri të Kosovës, ka një histori të gjatë që kaloi nëpër një proces jashtëzakonisht të gjatë. Më 10 qershor 1999 u lëshua urdhri për ndalimin e bombardimeve dhe KS i OKB-së, miratoi Rezolutën 1244, sipas të cilës në Kosovë u dërguan 37.200 ushtarë të KFOR-it nga 36 shtete. Me hyrjen e NATO-s, në Kosovë u vendos misioni i përkohshëm i OKB-së, i cili do të administronte vendin për një periudhë të caktuar kohore. Ardha e forcave ndërkombëtare shënoi një kthesë vendimtare për fatet e popullit të Kosovës. Ishte kjo një ditë me rëndësi vendimtare për historinë e Kosovës dhe një nga ditët më domethënëse dhe me kuptimplot për lirinë dhe për pavarësinë e saj. Mirëpo, pas Marrëveshjes së Kumanovës dhe në pajtim me marrëveshjen e Rambujesë u çarmatua UÇK-ja dhe u shëndërrua në Trupat Mbrojtëse të Kosovës (TMK).

Në fillim të vitit 2007 i dërguari special për statusin e Kosovës, Marti Ahtisaari, dorëzoi propozimin e tij, Prishtinës dhe Beogradit, "Standardet për Kosovën", në të cilën parashihej edhe shpërbërja e TMK-së, dhe krijimi i një force të re profesionale dhe shumë-etnike për sigurinë e Kosovës (FSK), e cila do të jetë e armatosur lehtë dhe do të jetë e aftë të mbulojë nevojat e caktuara të sigurisë.

Në vitin 2008, Kosova shpalli pavarësinë. Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë me seli në Hagë, që përfaqëson gjykatën e nivelit më të lartë të Kombeve të Bashkuara, në korrik 2010 publikoi vendimin se shpallja e pavarësisë së Kosovës nuk e ka shkelur të drejtën ndërkombëtare as rezolutën 1244 dhe kornizën kushtetuese të UNMIK, mirëpo Kosova prap nuk bëhet me ushtri.

Në janar 2009 u krijua Forca e Sigurisë së Kosovës, e cila fillimisht kishte përgjegjësi që të përballet me katastrofat e rënda, por nuk ishte ushtri. Pesë vite më vonë Qeveria e Kosovës merr vendim që të formohen Forcat e Armatosura të Kosovës (FSK), si ushtri të Kosovës. Mirëpo, vendimi nuk arriti të finalizohet asnjëherë. Sipas Kushtetutës së Kosovës për t'u vo-

*Përpjekjet për shtet të konsoliduar dhe sovran të Kosovës u kurorizuan më 14 dhjetor me miratimin e legjislacionit për formimin e ushtrisë së Kosovës. Tani po formohet ushtria më e re e popullit më të vjetër në Evropë, themelet e së cilës janë të vendosura në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe në luftën e lavdishme të UÇK-së*

tuar FSK-ja në Forcë të Armatosur duhen votat e dy të tretave të deputetëve të komunitetit serb.

Kështu, 20 vite pas çlirimit të vendit dhe 10 vite shtet i pavarur Kosova nuk ka pasur Forcë të Armatosur, edhe pse si shtet atë e kishin njohur më shumë se 100 shtete.

Prishtina thekson shifrën prej 116 shtete kurse Beogradi thonë janë më pak se 100 shtete që e njohin pavarësinë. Në mesin e shteteve të Bashkim Evropian që nuk e kanë njohur shtetin e Kosovës janë: Shpanja, Sllovakia, Greqia, Rumania dhe Qiproja. Pas shpalljes së pavarësisë në vitin 2008 Kosova u bë antare e disa organizatave ndërkombëtare si Fondi Ndërkombëtar Monetar, Banka Botërore, CEFTA, FIFA, por jo edhe antare e Kombeve të Bashkuara dhe nuk kishte Ushtrinë e saj.

Përpjekjet për shtet të konsoliduar dhe sovran të Kosovës u kurorizuan më 14 dhjetor me miratimin e legjislacionit për formimin e ushtrisë së Kosovës. Tani po formohet ushtria më e re e popullit më të vjetër në Evropë, themelet e së cilës janë të vendosura në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe në luftën e lavdishme të UÇK-së. Ajo do jetë ushtri moderne, që nuk do të lejoj cënimin e sovranitetit dhe integritetit të vendit, garantuese e paqes dhe stabilitetit në aspektin e sigurisë brenda Republikës së Kosovës dhe në rajon me synimin për të qenë pjesë e NATO-së dhe t'i kontribuoj qëllimeve madhore të kësaj aleance kudo në botë. Evolumi i FSK-së në Forcat e Armatosura të Kosovës është hap pozitiv dhe më se e natyrshme për Kosovën si vend sovran dhe i pavarur që të ketë aftësi vetëmbrojtëse. Andaj, Forcat e Armatosura të Kosovës tani duhet të fillojnë me punë praktike, transformimin, forcimin dhe të tregohen të aftë se do përmbushin detyrat e tyre në mënyrë të pavarur dhe me suksese.





## PERSONAZH

*Dy libra – testament për brezat ku përshkruhen më së miri vendlindja, historia e lavdishme, personazhe e personalitete që kanë bërë historinë e traditat më të mira*

# Shuaip Methasani, veterani që rrezaton mirësi dhe vlera

**Halil RAMA**

Pothuajse në të gjitha veprimtaritë promovuese të OBVL të dhjetë viteve të fundit, si edhe në Kuvendin Zgjedhor të majit të vitit të kaluar ka spikatur me prezencën dhe performancën e tij edhe veterani Shuaip Methasani. Intelktuali që mishëron vlerat më të mira njerëzore: zgjuarsinë, mençurinë, fisnikërinë, dashurinë njerëzore, sineritetin, drejtësinë, solidaritetin, moralin e lartë dhe shpirtin human si fundamente kyçe të shoqërisë sonë. Dhe të gjitha këto virtyte ai i përçon më së miri edhe në dy librat e tij: “Sohodolli i Dibrës” dhe “Kujtime në vite”. Dy libra – testament për brezat ku përshkruhen më së miri vendlindja e tij, Sohodolli, historia e lavdishme, personazhe e personalitete që kanë bërë historinë, traditat më të mira të këtij fshati e të krejt Dibrës. Janë padyshim dhuratat më e çmuar për njerëzit e familjes, farefisin, të afërmit, shokët e miqtë e tij të shumtë në gjithë Shqipërinë dhe hapësirën mbarëshqiptare në botë. Njeriu i mirë dhe i veprave të mira Shuaip Methasani gjatë gjithë jetës së tij ka rrezatuar dhe përçar mirësi, por dhe vlera në dobi të shoqërisë.

## TAVOLINA E DIBRANËVE

Tek libri “Kujtime në vite”, një mestitull interesant (faqe 62) është “Tavolina e dibranëve”. Intelktuali që ka shërbyer me devotshmëri e përkushtim qytetar për afro dy dekada, pothujase në të gjitha krahinat e fshatrat e Dibrës, edhe këtu në metropolin shqiptar, ku është vendosur familjarisht prej shumë vitesh, punon pa rreshtur për të lartësuar emrin dhe dinjitetin e dibranëve. Nëse në Tiranë njihen nga shumëkush “Rruga e Dibrës”, “Lagja e dibranëve”, (e krijuar e shumëfishuar përgjatë një shekulli që nga eksodi i tyre i 1913, e sidomos pas viteve 90), apo dhe Xhamia “Dine Hoxha” në rrugën e Kavajës (e ndërtuar me kontributin financiar të filozofit popullor të mirënjohur si një nga këshilltarët më të afërt të Mbretit Zog I), “Tavolina e dibranëve” në një lokal kafeneje në qendër të Kombinatit, është një tjetër vlerë e shtuar e këtij komuniteti, e ideuar dhe promovuar më së miri nga intelktuali i mirënjohur Shuaip Methasani. Është kjo, tavolina ku ai nuk mungon thajse asnjë ditë për t’u takuar e kuvenduar me miqtë e tij, jo vetëm dibranë, por edhe tepelenas, vlonjatë, shkodranë, nga Tirana dhe nga e gjithë Shqipëria.



“Duke përdorur edhe alegorinë dibrane në muhabete e sipër e me kundërshtime ndaj njëri-tjetrit, ato të tavolinave tjera dhe njerëzit e shërbimit në lokal çuditën me ne. Një ditë i kishin thënë asaj kamarieres 2-3 veta nga Jugu e Tiranës: More, po ata dibranët që u zunë dje në muhabete, a prapë qenkan bashkë?! Nuk u merret vesh dibranëve, kur flasin përdorin shumë thumba...”. Dhe në të vërtetë vetë Shuaipi është përçuesi më i mirë i alegorisë dibrane, të përvetësuar në odat e kuvendit e Dibrës, por edhe nga kryevepra e Hazis Ndreut “Alegoria dibrane” si dhe nga “Kanuni” i shkrimtarit të shquar dibran Xhafer Martini. Libri ka qenë miku dhe bashkëudhëtar më i mirë i Shuaip-it në tetë dekadat e jetës së tij, ndaj mos u çudisni nëse nga një vizitë rastësore në shtëpinë “Methasani” në një lagje të Kombinatit në Tiranë, do të gjeni një bibliotekë aq të pasur, konkurente në tituj e rubrika me ato të institucioneve. Ndërsa në bibliotekat tona, dy librat e tij duhet të zënë vend nderi, pasi ua kushton prindërve (babait Sulejman dhe nënës Fie), motrave Hike e Servete që e kanë mbajtur në krah kur ishte i vogël, bashkëshortes Farie - një zonjë e nderuar e fisnike, fëmijëve të mrekullueshëm: Defrim (moderator i shkëlqyer i dhjetra veprimtarive promovuese e argëtuese dhe ndër më të mirët e gazetarisë sportive në rang kombëtar), Artanit, Natashës, Nderimes e Lilianës që e kanë nderuar si me shkollimin dhe me punët ku kanë punuar e punojnë, dy nuseve të djemve, Lume e Naze, nipave e mbesave që e lumturojnë pafund, miqve dhe shokëve të tij të mrekullueshëm... Një përkushtim brilant për ata që përbëjnë embrionin e familjes nga buron atdeshashuria e tij e flaktë. Dhe në çdo faqe të tyre gjejmë aspekte nga historia e lavdishme e popullit tonë, por dhe ngjarje e detaje jetësore befasuese.



## JETA DHE VEPRIMTARIA E NJË INTELEKTUALI SHUMËDIMENSIONAL


Ka qenë fare i vogël, 6-7 vjeç, por e ka të ngulitur në kujtesë pushtimin fashist të vendit më 1939 dhe reagimin e tij prej fëmije të inatosur nga ky pushtim i egër. “Ishte prill 1939. E mbaj mend mirë kur erdhën italianët me makina e mushka të mëdha me artileri; kaluan lagjen tonë dhe dolën në vreshtat nën varre të Skëndere, vendosën çadrat e ushtrisë...ndërsa ne afroeshim ashtu si fëmijët që duan të shikojnë çdo gjë...”. Më tej kujton thirrjen e tyre italisht atëhere: “ej pikoli, vjeni kua, vjeni kua...” ndërsa vetë Shuaipi e shokët e tij të fëmijërisë, Imeri, Pajaziti, Zaimi, Cena, Hakiu etj, u afroeshin italianëve, e ata nxirrnin mallin e njerëzve të tyre që kishin në familjet e veta....

Në vitin 1944 vijon mësimet në shkollën fillore të xhamia, me mësues Halil Shehun nga Vlesha e të tjerë që erdhën më vonë nga Vlora, Elbasani e Shkodra...Nxënësi i zellshëm Sh.Methasani më pas do të ngjiste shkallët e dijes e formimit arsimor e kulturor në të gjitha nivelet: 7-vjeçare, pedagogjike e deri të lartën. Që nga 1944 e deri në mbarimin e shkollës së lartë ka kaluar me shumë shokë e shoqe, në klasa paralele e audiore të ndryshme. “Kështu, e fillova me Osman Hysen Pajazitin, Xhemën, Alushin, Cenën, Ismetin e Selimin dhe e mbarova me Nikollë Brozin nga Mirdita, Omer Hashorvën nga Gjirakastra, me Mentor Muçen, Rustem Devën, Vera Haxhiun, Liljana Mitin, Shpresa Barbullushin, Nikoll Kolën, Izet Durmishin, Hajdar Kastratin, Rustem Lleshin, Servet Pëllumbin, etj”, shkruan Shuaipi në librin e tij “Kujtime në vite” (faqe 53). Janë vërtetë kujtime mallëngjyese por edhe mbresëlënëse jo vetëm për autorin, por edhe për lexuesin. Të përshkruara mjeshtërisht si mbresa e kujtime nga jeta e puna e tij në zonën e Shupenzës e Gjoricës (1968-1971), në Zogje të Dibrës (1982-1984), në Kalanë e Dodës – ballkonin natyror të Dibrës e gjithë Shqipërisë ku punoi e jetoi për 12 vjet (1971-1982), në zonën e Çidhnës (1984-1989), në Sllovë, etj, formojnë profilin e këtij intelektual që kudo shërbeu me devotshmëri e përkushtim qytetar.

Vetëm një intelektual i mirëfillt si Sh.Methasani, duke e konsideruar mirënjohjen si shprehjen më të bukur të karakterit të njeriut, në moshën e tretë merr penën dhe shkruan me realizëm e objektivitet për shokët e miqtë e tij të shumtë. Kështu ai në dy faqe të librit të tij me kujtime (12-13) rendit emrat e qindra intelektualëve dibranë me të cilët ka patur fatin të punojë. Dhe po me atë dashuri të pakufishme shkruan për “Dibrën e margaritarëve”, Dibrën e 9 maleve, teqeve dhe oxhaqeve të përmendura...Ndërkohë si kontribut real

në gjeopolitikë ai jep përkufizime të qarta për “Dibrën e shtrirë në një hapësirë pa fund, si një vilajet i stërmadh, që nis nga Mati në njërin anë e nga Luma në tjetrën dhe duke pasur përbri e afër këtej Kukësin, Mirditën e Librazhdin, e matanë, Strugën e Ohrit dhe pas më larg Kërçovën, Tetovën etj, me një reliev të thyer, plot me male, kodra, ultësira, fusha e lugina...Ai përshkruan bukur e thjeshtë: Dibrën e Korabit gjigand e legjendar dhe disa male të tjera që i qëndrojnë krahinës si një kurorë e bukur mbi kokë, duke ia shtuar edhe më shumë madhështinë e krenarinë; Dibrën e Drinit të Zi që gjarpëron mijëra metra tejmbanë Veriut dhe pasi bashkohet me Drinin e Bardhë arrin në Shkodër tok me Bunën e derdhen në Adriatik; Dibrën e shtatë liqjeve margaritarë e piktoreskë të Lurës; Dibrën e shumë pasurive të mëdha natyrore, kromit, gipsit, sulfurit e lixhave ku kurohen me mijëra njerëz; Dibrën e traditave në bujqësi e blegtori, të frutikuturës, sixhadeve e qylymave të Kalasë së Dodës; Dibrën e sofrës, pushkës e penës, urtësisë dhe mençurisë; Dibrën e arsimit, kulturës, sportit, besës e flamurit; të fiseve e familjeve të mëdha e emrave që kanë shkruar e bërë histori, si: Gjergj Kastrioti, Iljaz Pasha, Elez Isufi, Nikollë Kaçorri, Vehbi Dibra(Agolli), Dine Hoxha etj; Dibrën e shumë heronjve, mësuesve e pedagogëve, inxhinierëve, mjekëve e mjeshtërve të artit, kulturës dhe sportit, si: Haki Stërmilli, Haki Sharofi, Suljeman Pitarka, Drita e Esma Agolli, Muharrem Xhediku, Hazis Ndreut, Shaban Sinani, Agron Tufa, Bujar Kapexhiu, Gëzim Erëbara, Femi e Tasim Oshafi, Avni Resuli, Zenulla Hatibi, Xhemil Simixhiu, Agim Krajka, Hiqmet e Nexhat Agolli, Adivie e Yllka Sharofi, Edip e Enjëll Tërshana, Sadik Botku, Liri Rasha, Arif Vladi, Arben Spahiu etj....Po ashtu e gjejmë Shuaipin përkrah të birit gazetar e moderator, Defrimit, tek promovon të mëdhenjtë e sportit, kampionët botëror Erzen Rustemi, Ismail, Gjetan e Ferit Keta, Bari Mehmeti (Meçollari) apo dhe artistin shqiptaro-amerikan me famë botërore Xhevat Limani. Dhe si gjerdan në kurorën e lavdisë dibrane, ai nuk nguron të rendisë edhe miset shqiptare me origjinë dibrane Denisa Kola, Ilda Reka e Migena Ramadani.

Vetëm një studjues tejet i vëmendshëm e skurpuloz si Shuaip Mehtasani mundet të evidentojë kaq shumë emra të spikatur dibranësh në fusha të ndryshme, siç evidenton “odën e burrave”, “traditën e fisit”, objektet dalluese të vendlindjes së tij, “sohodollasit e Tiranës” apo “Familjet nga Sohodolli me banim në Tiranë”. Parë në tërësinë e individualitetit të tij krijues, Shuaip Methasani është një enciklopedi e gjallë për Dibrën e dibranët.





## PROFIL

# SHPENDI TOPOLLAJ – KRITIKU ME STIL TË QARTË DHE KULTURË TË MADHE

Dr. Shk. Novruz Zejnati

Shpendi Topollaj i rreh krahët e tij të fuqishëm në qiellin e pastër të letërsisë të viteve të demokracisë, duke ardhur nga radhët e ushtrisë, pavarësisht se për një kohë të gjatë ai shërbeu me nder në organet e drejtësisë. Duke qenë aq i dalluar në veprimtarinë poliedrike si poet, prozator, publicist dhe kritik letrar, ai mbetet ndofta më solidi në vlerat e tij të rralla njerëzore. E nëqoftë e vërtetë (dhe s'ka sesi të mos jetë e tillë), që ai është nga krijuesit më prodhimtarë dhe më cilësorë të vendit tonë, unë do theksoja se po kaq harmonik është ai në qenien shkrimtar dhe njeri.

Duke qenë prej një kohe të gjatë pranë tij si shok e mik i pandarë, gjë që kujt do t'i bënte nder, më ka ndodhur të shkruaj rreth figurës së tij të jashtëzakonshme, qoftë dhe si parathënie librash. Por duke e ndierë gjithmonë, se edhe pse për të kanë shkruar me aq simpati e vlerësim, shumë nga penat tona më të shquara, përsëri për talentin dhe vlerat e tij ende ka shumë e shumë për të thënë, kërkoj me insistim që edhe për këtë libër, të jepja konsideratat e mia modeste.

Ky libër që po i jepet ndër dual lexuesve, as më shumë e as më pak, por është vazhdim i pandërprerë i një kulture superiore, një mendjeje të fuqishme dhe një shpirti të madh. Ai, gjithashtu është rezultat i dashu-



risë që ai ka si për letërsinë ashtu dhe për autorët që e bëjnë atë. Shpendi në çdo shkrim kritik, përdor një gjuhë të rrjedhshme dhe të ëmbël, dhe nxjerr thelbin e mesazheve të shkrimtarit që analizon, duke e lidhur atë me realitetet që kalojmë.

Dhe mbi të gjitha, ai mbetet në çdo rast i kuptueshëm dhe i thjeshtë, ashtu sikurse thosh ushtaraku tjetër Anri Bejli, pra Stendali se “Cilësia e vetme që duhet arritur në stil është qartësia.” Kritikët letrarë që të pak-tën për nga volumi janë shumë larg Shpendit, patjetër që kanë vlerat e tyre. Por kur lexon analizat e thella të këtij autori, bindesh se je para një trajtimi krejt tjetër të kësaj gjinije, për të mos thënë se në kritikën letrare shqiptare, ai ka krijuar një zhanër të ri, të panjohur më parë. Zakonisht ata që merren me kritikë, përqendrohen te një gjini, fjala vjen poezi apo prozë patjetër letrare.

Kurse Shpendi, me lehtësinë më të madhe dhe po ashtu, me kompetencën më të madhe, në shkrimet e tij, nuk ka ndonjë preferencë të veçantë; ai analizon krahas librit me poezi apo prozë edhe atë të një historiani, përkthyesi, oficeri, shkencëtar, politikani, mësuesi, botuesi, sportisti, muzikanti, kleriku, administratori, diplomati, regjisor apo akademiku, sikurse bën edhe në këtë libër. Kujt do i lind pyetja e natyrshme se si ka arritur ai, krahas kokëçarjeve të pambarimta të detyrës, punës prej tre dekadash me ushtarët, të ngrinte nivelin e tij kaq lart. Dhe për mendimin tim, ai e ka arritur këtë vetëm me anën e leximeve, aq sa sot duket paradoksale dhe e pabesueshme, po të sjellim ndërmend se ai edhe është dënuar nga diktatura komuniste, po për lexim librash. Dhe mundet që janë pikërisht këto lexime që ja kanë zhvilluar atij kujtesën në

kufijtë e të paimagjinueshmes.

Ashtu sikurse janë ata librat që atij do t'ja shohësh çdo ditë në dorë, që e mbajnë këtë kujtesë të freskët dhe të denjë për mendjen e një enciklopedisti të vërtetë. Shihni si vallzon ai me mitologjinë. Kush tjetër ka shkruar apo e ka përdorur këtë mitologji, qoftë dhe në kritikë, si ai? Kurse ndjeshmëria dhe ëmbëlsia e penës së tij, mendoj se është e lindur; atë do ta konstatoosh fare lehtë edhe te libri pararendës “Romancë me letra dashurie” të shkruara kur qe vetëm 20 vjeç. Dashje pa dashje sepse të duket se atë e ka shkruar vetë Kupidi.

Kur zhytesh në hapësirën e librit me kritika “Purgatori i librave”, ashtu siç bën në të gjithë librat e shumtë në këtë gjini (ato janë mbi 20 të tilla), dhe vëren se Shpendi përshkruan me ato ngjyra aq të gjalla dhe aq shprehëse, të duket se është vetë autori i librit që analizohet, ai që flet. Ai hyn në lëkurën dhe shpirtin e personazheve, sikur ata të ishin të krijuar prej tij. Për më tepër, ai i vesh e zhvesh sipas rastit, i zbukuron e i bën aq të afërt për lexuesit e çdo moshe. Kur ta keni lexuar këtë libër, do vini re se ky autor flet me ju me pasion dhe seriozitet të pakrahueshëm dhe ty s'të mbetet tjetër veçse ose të lexosh librin në fjalë ose të kup-tosh se kultura ngadhënjën mbi injorancën, fantazia mbi shterpësinë, qytetërimi mbi barbarinë, gjenia krijuese mbi atë shkatërruese.

Të gjitha shkrimet e Shpendi Topollajit të përfshira në këtë, kanë një ritëm të brendshëm që të rrëmben e të bën për vete. Ashtu sikurse ai që ka lexuar një vepër letrare të tij do të kërkojë të shtjerë në dorë një tjetër, edhe shkrimet e këtij libri, të shtynjë t'i lexosh të gjitha trajtesat që ai ka vendosur këtu.

Ndaj është vështirë të mos i çosh me kënaqësi deri në fund ato dhe të

mos i shijosh intelektualisht për ato vlera artistike dhe estetike që mbartin. Pa frikë mund të them se të gjithë ata që veprën e tyre ua merr në analizë një personalitet si Shpendi Topollaj, duhet të quhen me fat. Kjo edhe për faktin se ai jo vetëm i boton shkrimet e tij nëpër gazeta, por edhe se me një gojtari të pashoqe i ligjëron kudo para auditorëve nga më të shquarit. Fjalimet e tij që në Akademinë e Shkencave i kanë quajtur me të drejtë brilante, lënë te çdo dëgjues mbresa të pashlyera. Në këtë drejtim ai mbete një tribun i vërtetë, por pa fat që nuk jetoj në kohën e Demosdenit dhe të Ciceronit. Fjala e tij, pa asnjë përpjekje për emfaza, ka diçka nga rrapëllima plot refleksje ylberesh e një ujëvare.

Atje nuk ka asgjë të tepërt dhe asgjë të mangut. Citimet që përdor, si mençuria e madhe e përmbledhur në vetëm pak fjalë dhe për të cilën po Bejli shprehet se “Aftësia për të cituar saktësisht është një talent shumë më i rrallë nga ç'duket”, i japin shkrimeve të Shpendit një bukuri e shkëlqim të veçantë. Lavjerrësi i tensionit dramatik deri sa mbërrin erupsioni shpërthyes, janë gati - gati të prekshme dhe rreptësisht llogjike, ndaj dhe të mbajnë të ngërthyer dhe me një gjendje emocionale të veçantë. Me pak fjalë, ju do të bindeni vetë gjatë leximit të këtij libri se ç'ngjet me personazhet e tij: të vdekurit si K. Luarasi, D. Agolli,



K. Ylli, R. Ajazi, B. Sahatçiu, A. Fejzo, H. Tafa, M. Ciko, N. Dervishaj, J. Budo i ngjall, dhe të gjallët si K. Kyçyku, Xh. Mustafa, J. Doja, A. Bojaxhiu. R. Reka, L. Shehu, N. Roli, A. Kadenasi, etj. i bën të pavdekshëm.

Ja kjo është forca e vërtetë e mendjes dhe sidomos shpirtit të madh human të poetit, shkrimtarit dhe kritikut letrar, mikut tim të mirë Shpendi Topollaj, të cilit si pakkujt i shkojnë fjalët e poetit lirik gjerman Frederik Holderini: “Mëso artin në jetë dhe jetën në veprën artistike. Nëse e sheh qartë njërën, qartë do ta shohësh dhe tjetrën.”





## SPORTI

*Ish Sekretari Organizativ i Federatës së Alpinizmit shqiptar, dekoruar me Titullin “Mjeshtër i Madh”*

# Alpinisti nga Lura Lazer Rajta, në krye të Shoqatës Alpinistike “Tirana”

**Halil RAMA**

Lazer Rajta ishte vetëm 22 vjeç kur u inkuadrua në Repartet Speciale të Forcave të armatosura në ish-koorpusin e Burrelit. Djaloshi energjik që vinte nga Lura, kjo perlë turistike e vendit tonë, ndonëse, ndoqi të gjitha shkallët hierarkike si ushtarak i Forcave të Armatosura, duke kryer detyra e funksione të rëndësishme, që në fillimet e karrierës së tij do t’iu kushtojë maksimalisht edhe veprimtarive sportive.

Në vitin 1980, me iniciativën e tij u ngrit ekipi i alpinizmit në Burrel dhe që atë vit ai merr pjesë në veprimtari kombëtare.

Katër vjet më vonë (1984), alpinisti Lazer Rajta ngjitet në kategorinë e parë si trajner i ekipit të alpinizmit të rrethit të Matit. Po atë vit (12.12.1984) merr titullin “Mjeshtër Sporti” për rezultate të larta në sportin e alpinizmit duke thyer rekorde të ngjitjeve të vështira në Alpet e Shqipërisë, të certifikuara nga profesorë dhe mjeshtër të alpinizmit shqiptar.

Në sport, ashtu si edhe në art, pasioni sjell talentin. Kësisoj, Lazer Rajta, i aposionuar pas alpinizmit, nuk i ndahet për asnjë çast këtij sporti, ku në harkun kohor të 16 viteve (1980-1996) zgjidhet anëtar i kryesisë së Klubit Sportiv të rrethit të Matit. Matjanët e mbajnë mend ish-ushtarakun e talentuar të ish-koorpusit të Burrelit teksa për vite të tëra fitonte anketën “10 sportistët më të mirë të rrethit të Matit”.

Pas hapjes së Shqipërisë më botën edhe alpinizmi shqiptar do të njihet lartësi të reja, e në këtë kuadër, sportisti Lazer Rajta që më 1991 do të merrte pjesë në Kampionatin Ndërkombëtar të Alpinizmit që u zhvillua në Rumani. Janë mbresëlënëse kujtimet e atij kampionati, kur për herë



të parë mes dhjetra alpinistëve shqiptarë, edhe lurjani Lazer Rajta do të ngjitej në majat më të larta të zonës së Broshovës, Rumani. Pas transformimit të ushtrisë shqiptare në një ushtri e standardeve të NATO-s, kur u reduktua dukshëm edhe numri i ushtarakëve edhe Lazeri del në reformë.

Gjithsesi ai mbetet një ikonë e ushtrisë dhe sportit. Kjo edhe për faktin se të bëje karrierë në Burrel, të konsideruar si qytet i ushtarakëve, nuk ishte e lehtë, pasi këtu, më shumë se në çdo qytet apo rreth tjetër gëlonin intrigat dhe thureshin prapaskena në kurriz të intelektualëve të suksesshëm. Por Lazer Raja ia doli falë mençurisë, intuits dhe largamësisë së tij. Kudo e në çdo rrethanë ai demostroi profesionalizëm të lartë, zotësi e përkushtim, virtyte morale e humane si një nga përfaqësuesit më të denjë të Forcave tona të Armatosura. Në të gjitha funksionet fitoi besueshmërinë e lartë, respektin e

konsoliduar dhe prestigjin që figura e ushtarakut shqiptar gëzon me meritë tek qytetarët e këtij vendi.

Ndërkohë, ai asnjëherë nuk shkëputet nga sporti i alpinizmit. Kishte shërbyer me devotshmëri e përkushtim si Drejtor i Shtëpisë së Ushtrarakëve të Koorpusit të Burrelit për tre vjet (1993-1996) dhe si instruktor i parë i Përgatitjes Fizike të Forcave RENE në Kombin (1996-1998) dhe si i tillë e përjetoi disi i “pezmatuar” daljen në reformë, por jo shkëputjen nga puna. Në jetën civile tashmë do të shpaloste vizionin dhe talentin e tij edhe në fushën menaxheriale si menaxher tek “Rozafa” dhe si Koordinator (shëf sigurie) në QSUT Tiranë. Dhe për asnjë çast edhe këtu në metropolin shqiptar nuk i ndahet alpinizmit.


Ish Sekretari Organizativ i Federatës së Alpinizmit shqiptar L.Rajta (1996-2000), katër vjet më vonë (2004) krijoi Shoqatën Alpinistike “Tirana” dhe aktualisht është President i Kësaj

të rinjve dhe masivizimin e këtij sporti.

Me Shoqatën Alpinistike “Tirana” po jep kontribut edhe në lëvizjen turistike në vendet malore e turistike.

Në vlerësim të kontributit shumëvjeçar në sportin e alpinizmit dhe për edukimin e brezave nëpërmjet këtij sporti, Presidenti i Republikës së Shqipërisë e ka dekoruar z.Lazër Rajta me Titullin “Mjeshtër i Madh”. Vetë motivacioni i këtij Titulli që mban dekretin presidencial nr. 9667, datë 28.06.2016 është vlerësim real “Për ndihmesën e çmuar të dhënë për shumë vite në përhapjen e masivizimin e sportit të alpinizmit në vendin tonë, anëtar i ekipit kombëtar të alpinizmit, pjesëmarrës me rezultate të larta sportive në ngjitje alpinistike të organizuara në veprimtari të rëndësishme të aktiviteteve kombëtare e ndërkombëtare”.

Lazër Rajta është krenar për historinë e alpinizmit shqiptar, i cili në Shqipëri i ka fillesat e tij që nga vitet 20 të shek.XX, kur grupe të vogla të rinjsh bënë ngjitje të thjeshta në male. “Pas 1944-s alpinizmi u vlerësua si sport, si mjet edukimi dhe për njohjen e vendit. Deri në vitet 50-60 u kryen mjaft ngjitje malore, më e rëndësishmja në majën më të lartë të Korabit në shkurt 1956. Që nga ky vit filloi edhe stërvitja e organizuar sipas kërkesave teknike sportive. Alpinistët shqiptarë janë ngjitur në të gjitha majat mbi 1800 të Shqipërisë gjatë verës e dimrit dhe kanë kryer ngjitje në vende të tjera. Para 90-s vepronin 22 ekipe të alpinizmit dhe shumë ekipe me të rinj e pionerë dhe klasa sportive në shkolla 8-vjeçare”, - pohon Presidenti i Shoqatës Alpinistike “Tirana” Lazer Rajta. Ai ndjehet optimist për një rilindje të veprimtarive alpinistike e cila pasqyrohet edhe me emra alpinistësh krejt të rinj, ndërkohë që ka prej tyre që realizojnë itinerarë cilësorë në kacavarje dhe ka të tjerë të cilët po bëjnë emër me ngjitjen e majave të mbuluara nga bora dhe akulli.



Shoqate.

Në vitin 2006 ai dekorohet me “Medaljen e Mirënjohjes” për kontributet në zhvillimin dhe promovimin e alpinizmit shqiptar. Ky kontribut është i dukshëm veçanërisht në organizimin e



## Përmëtarët nderojnë sakrificat dhe gjakun e dëshmorëve

**(Vijon nga faqja 7)**

U vendosën kurora në emër të Bashkisë nga kryetari Z.Niko Shupuli dhe nënkryetarët Znj. Etleva Kreci dhe Z.Llazar Thanasi, Këshilli Bashkiak, kryetarja dhe sekretari Znj. Mira Habili dhe Z. Veli Mehmeti, Këshilli i Qarkut Z. Roland Dama dhe Z. Leonard Kola, Prefekturës, Major Z. Fadil Guci dhe Pranvera Lapaj, OBVL dhe Komitetit të Veteranëve, sekretari Ahmet Mane dhe nënkryetari Vasil Papa, të organizatës familjeve të dëshmorëve, sekretari Argjir Koto dhe Muharem Kamani etj.

Në dhomën muzeale mbasi u lanë shënime në librin e nderit, u foli anëtar i kryesisë i familjeve të dëshmorëve Ahmet Mane për kontributin e popullit të Përmetit që i ka dhënë LANÇ 185 dëshmorë dhe 12 dëshmorë të periudhës së parësishme kombëtare.

Bashkia në lokalit “Lulishtja” shtroi një koktejl për të gjithë pjesëmarrësit ku të pranishmit i

përshëndeti Kryetari i Bashkisë duke ju uruar festën. Ambjenti u gjallërua nga Sazet e Përmetit të cilët këndonin këngë partizane, patriotike dhe qytetarë përmëtarë.

Kryetari i Shoqatës AK Përmeti Z.Kastriot Bezati bëri një ekspozitë të gjatë për kontributin që ka dhënë populli i Përmetit në të gjitha periudhat historike dhe në veçanti u ndal në periudhën e luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare.

Sekretari i FD Argjir Kote foli për domosdoshmërinë e mirëmbajtjes së varrezave të dëshmorëve, lapidarëve, pllakave përkujtimore, simboleve dhe muzeumeve.

Për periudhën 5 Maj 2018 deri në 29 Nëntor janë bërë 25 pranime të reja në organizatën tonë, disa prej të cilëve përfitojmë nga rasti duke u dorëzuar dokumentin e anëtarësisë në këtë ditë të shënuar si: Aleko Duka, Mbares Medi Vila, Ahmet Mane, Pranvera Lapaj, Bashkim Zaimi.

Festa kaloi gëzueshëm nën tingujt e muzikës të Sazeve të Përmetit.



# Gëzuar 2019!



| JANAR |    |    |    |     |    |     |
|-------|----|----|----|-----|----|-----|
| D     | He | Ma | Më | Enj | Pr | Sht |
|       |    | 1  | 2  | 3   | 4  | 5   |
| 6     | 7  | 8  | 9  | 10  | 11 | 12  |
| 13    | 14 | 15 | 16 | 17  | 18 | 19  |
| 20    | 21 | 22 | 23 | 24  | 25 | 26  |
| 27    | 28 | 29 | 30 | 31  |    |     |

| SHKURT |    |    |    |     |    |     |
|--------|----|----|----|-----|----|-----|
| D      | He | Ma | Më | Enj | Pr | Sht |
|        |    |    |    |     | 1  | 2   |
| 3      | 4  | 5  | 6  | 7   | 8  | 9   |
| 10     | 11 | 12 | 13 | 14  | 15 | 16  |
| 17     | 18 | 19 | 20 | 21  | 22 | 23  |
| 24     | 25 | 26 | 27 | 28  |    |     |

| MARS |    |    |    |     |    |     |
|------|----|----|----|-----|----|-----|
| D    | He | Ma | Më | Enj | Pr | Sht |
|      |    |    |    |     | 1  | 2   |
| 3    | 4  | 5  | 6  | 7   | 8  | 9   |
| 10   | 11 | 12 | 13 | 14  | 15 | 16  |
| 17   | 18 | 19 | 20 | 21  | 22 | 23  |
| 24   | 25 | 26 | 27 | 28  |    |     |



| PRILL |    |    |    |     |    |     |
|-------|----|----|----|-----|----|-----|
| D     | He | Ma | Më | Enj | Pr | Sht |
|       | 1  | 2  | 3  | 4   | 5  | 6   |
| 7     | 8  | 9  | 10 | 11  | 12 | 13  |
| 14    | 15 | 16 | 17 | 18  | 19 | 20  |
| 21    | 22 | 23 | 24 | 25  | 26 | 27  |
| 28    | 29 | 30 |    |     |    |     |

| MAJ |    |    |    |     |    |     |
|-----|----|----|----|-----|----|-----|
| D   | He | Ma | Më | Enj | Pr | Sht |
|     |    |    | 1  | 2   | 3  | 4   |
| 5   | 6  | 7  | 8  | 9   | 10 | 11  |
| 12  | 13 | 14 | 15 | 16  | 17 | 18  |
| 19  | 20 | 21 | 22 | 23  | 24 | 25  |
| 26  | 27 | 28 | 29 | 30  | 31 |     |

| QERSHOR |    |    |    |     |    |     |
|---------|----|----|----|-----|----|-----|
| D       | He | Ma | Më | Enj | Pr | Sht |
|         |    |    |    |     |    | 1   |
| 2       | 3  | 4  | 5  | 6   | 7  | 8   |
| 9       | 10 | 11 | 12 | 13  | 14 | 15  |
| 16      | 17 | 18 | 19 | 20  | 21 | 22  |
| 23      | 24 | 25 | 26 | 27  | 28 | 29  |
| 30      |    |    |    |     |    |     |



| KORRIK |    |    |    |     |    |     |
|--------|----|----|----|-----|----|-----|
| D      | He | Ma | Më | Enj | Pr | Sht |
|        | 1  | 2  | 3  | 4   | 5  | 6   |
| 7      | 8  | 9  | 10 | 11  | 12 | 13  |
| 14     | 15 | 16 | 17 | 18  | 19 | 20  |
| 21     | 22 | 23 | 24 | 25  | 26 | 27  |
| 28     | 29 | 30 | 31 |     |    |     |

| GUSHT |    |    |    |     |    |     |
|-------|----|----|----|-----|----|-----|
| D     | He | Ma | Më | Enj | Pr | Sht |
|       |    |    |    | 1   | 2  | 3   |
| 4     | 5  | 6  | 7  | 8   | 9  | 10  |
| 11    | 12 | 13 | 14 | 15  | 16 | 17  |
| 18    | 19 | 20 | 21 | 22  | 23 | 24  |
| 25    | 26 | 27 | 28 | 29  | 30 | 31  |

| SHTATOR |    |    |    |     |    |     |
|---------|----|----|----|-----|----|-----|
| D       | He | Ma | Më | Enj | Pr | Sht |
| 1       | 2  | 3  | 4  | 5   | 6  | 7   |
| 8       | 9  | 10 | 11 | 12  | 13 | 14  |
| 15      | 16 | 17 | 18 | 19  | 20 | 21  |
| 22      | 23 | 24 | 25 | 26  | 27 | 28  |
| 29      | 30 |    |    |     |    |     |



| TETOR |    |    |    |     |    |     |
|-------|----|----|----|-----|----|-----|
| D     | He | Ma | Më | Enj | Pr | Sht |
|       |    | 1  | 2  | 3   | 4  | 5   |
| 6     | 7  | 8  | 9  | 10  | 11 | 12  |
| 13    | 14 | 15 | 16 | 17  | 18 | 19  |
| 20    | 21 | 22 | 23 | 24  | 25 | 26  |
| 27    | 28 | 29 | 30 | 31  |    |     |

| NENTOR |    |    |    |     |    |     |
|--------|----|----|----|-----|----|-----|
| D      | He | Ma | Më | Enj | Pr | Sht |
|        |    |    |    |     | 1  | 2   |
| 3      | 4  | 5  | 6  | 7   | 8  | 9   |
| 10     | 11 | 12 | 13 | 14  | 15 | 16  |
| 17     | 18 | 19 | 20 | 21  | 22 | 23  |
| 24     | 25 | 26 | 27 | 28  | 29 | 30  |

| DHJETOR |    |    |    |     |    |     |
|---------|----|----|----|-----|----|-----|
| D       | He | Ma | Më | Enj | Pr | Sht |
| 1       | 2  | 3  | 4  | 5   | 6  | 7   |
| 8       | 9  | 10 | 11 | 12  | 13 | 14  |
| 15      | 16 | 17 | 18 | 19  | 20 | 21  |
| 22      | 23 | 24 | 25 | 26  | 27 | 28  |
| 29      | 30 | 31 |    |     |    |     |

